



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 15 (827767)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 15 Prill 2022

Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj inspekton trajnimin e ushtarakëve të Forcës Tokësore nga Garda Kombëtare e New Jersey-it

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe atasheu ushtarak amerikan në vendin tonë CDR David Millner, inspektuan trajnimin që batalioni i Dytë i Këmbësorisë (b2k), po zhvillon prej disa ditësh me ekspertët ushtarakë të Gardës Kombëtare

të New Jersey-it. Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj ndoqi nga afër demonstrime në të tre stacionet stërvitore: shëndetësi, përgatitje zjarri me mortaja të kalibrit 60 mm dhe 80 mm si dhe mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara, gjithashtu u njoh nga ekspertët amerikanë me programin e aplikuar gjatë këtyre ditëve të trajnimit, me efektivët e b2k të Forcës Tokësore. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm adresoi

një falënderim për të gjithë pjesëmarrësit në këtë trajnim dhe në mënyrë të veçantë ekipin e ushtarakëve amerikanë, për asistencën e tyre në rritjen e nivelit profesional të trupave të b2k, si bërthama e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, dhe shprehu bindjen se ky trajnim, por edhe të tjerët që priten në vijim në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të...

» faqe 2



Përrurohet Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile

Ministri Peleshi: Hapi i parë drejt ngritjes së një sistemi modern të Mbrojtjes Civile



» faqe 3

“Defender Europe 2021”, ndihma për qendrën shëndetësore të Shëngjergjit pas stërvitjes së përbashkët

Qendra Shëndetësore e Shëngjergjit është pajisur me aparatura e medikamente shtesë, falë ndihmës së projektit të ekipit të përbashkët shqiptaro-amerikan të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak. Ky donacion vjen pas një vlerësimi që iu bë situatës gjatë stërvitjes së përbashkët “Defender Europe 2021”. Në ceremoninë e dhurimit, zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici shprehu falënderimin për palën amerikane dhe Komandën Europiane, e cila financoi këtë donacion. “Kjo është një ndihmë...



» faqe 2

Ministri Peleshi: NATO mbështet financiarisht çdo projekt novator për të luftuar dezinformimin

NATO ka nisur një projekt, në vendet anëtare, kundër dezinformimit dhe veprimtarive armiqësore të informacionit. Në një njoftim për shtyp, NATO bën të ditur se do të ofrojë grante për ide të reja në fushën e informacionit, duke u mundësuar vendeve të Aleancës që të jenë më elastike ndaj dezinformimit dhe veprimtarive armiqësore të informacionit. Teksa ka dhënë më shumë informacione për këtë nismë, Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u shpreh se: “Dezinformimi dhe veprimtaritë armiqësore...



» faqe 3

Pse u tkurr makineria ruse e luftës

Mistika e stërvitjes ushtarake me të cilën Kremlin veshi rrethimin prej 5837 km të kufirit të Ukrainës, e invazionit ushtarak dhe e kërcënimit apokaliptik që i lëshoi botës në mëngjesin e 24 Shkurtit 2022, dalëngadalë po davaritet. Pasi aplikoi një shartim hibrid strategjik e taktikash, me pothuajse të gjitha llojet e armëve dhe angazhoi mbi 70 për qind të të gjitha forcave që ka në dispozicion, aktualisht makineria ruse po tërhiqet për t'u përqendruar në mbajtjen me çdo kusht në dy “republika autonome” dhe, mundësisht, në tërë brezin që i lidh ato me Krimenë, ku përfshihet edhe Porti...



» faqe 14

Projekti

Qendra Shëndetësore e Shëngjergjit është pajisur me aparatura e medikamente shtese, falë ndihmës së projektit të ekipit të përbashkët shqiptaro-amerikan të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak. Ky donacion vjen pas një vlerësimi që iu bë situatës gjatë stërvitjes së përbashkët “Defender Europe 2021”. Në ceremoninë e dhurimit, zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici shprehu falënderimin për palën amerikane dhe Komandën Europiane, e cila financoi këtë donacion. “Kjo është një ndihmë e parë, por duke parë më tej nevojat që ka ky komunitet besoj se në të ardhmen edhe me ndihmën e vyer të Ambasadës amerikane ne do të kemi më shumë për komunitetin tuaj”, - iu drejtua ajo banorëve të zonës dhe punonjësve.

Nga ana e tij, zëvendës ambasadori amerikan Demian Smith tha se kjo



ndihmë është një shenjë falënderimi për banorët e zonës dhe Shqipërinë, e cila punoi krah SHBA-së për suksesin e stërvitjes “Defender Europe ‘21”. “Mbështetja juaj gjatë stërvitjes së përbashkët “Defender ‘21” ishte vendimtare për suksesin tonë të përbashkët. Kjo ngjarje historike i tregoi edhe një herë botës se Shqipëria është një ale-

ate e pakrahasueshme në mikpritjen e miqësinë e saj. Puna jonë e përbashkët nuk ka përfunduar teksa festojnë 100 vjet miqësi. “Defender ‘21” ishte vetëm fillimi i një rruge të gjatë që kemi përpara. Shqipëria është ofruar edhe një herë për stërvitjen e ardhshme ushtarake, për t’i treguar edhe një herë botës se nuk ka miqësi më të fortë”, - u shpreh zëvendës ambasadori Smith.

Zëvendësministria e Shëndetësisë Mira Rakacolli, e pranishme në ceremoni, falënderoi SHBA-të për kontributin e dhënë edhe gjatë kohës së pandemisë, duke theksuar se për shëndetësinë gjithmonë ka nevojë për më shumë.

Pajisjet dhe medikamentet shëndetësore të dhuruara do t’i shërbejnë edhe fshatrave përreth zonës së Shëngjergjit.



BASHKËPUNIMI

Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj inspekton trajnimin e ushtarakëve të Forcës Tokësore nga Garda Kombëtare e New Jersey-it

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe atashu ushtarak amerikan në vendin tonë CDR David Millner, inspektuan trajnimin që batalioni i Dytë i Këmbësorisë (b2k), po zhvillon prej disa ditësh me ekspertët ushtarakë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj ndoqi nga afër demonstrime në të tre stacionet stërvitore: shëndetësi, përgatitje zjarri me mortaja të kalibrit 60 mm dhe 80 mm si dhe mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara, gjithashtu u njoh nga ekspertët amerikanë me programin e aplikuar gjatë këtyre ditëve të trajnimit, me efektivët e b2k të Forcës Tokësore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm adresoi një falënderim për të gjithë pjesëmarrësit në këtë trajnim dhe në mënyrë të veçantë ekipin e ushtarakëve amerikanë, për asistencën e tyre në rritjen e nivelit profesional të trupave të b2k, si bërthama e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, dhe shprehu bindjen se ky trajnim, por edhe të tjerët që priten në vijim në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të jenë shumë të vlefshme për trupat e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, gjatë certifikimit të tyre në muajin shtator.



Emergjencat

Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Komitetit për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i ka bërë ftesë të gjitha njësive të qeverisjes vendore për të aplikuar për programin “Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”. Ky fond, me vlerë totale 4 milionë dollarë, mund të përfitohet nga të gjitha bashkitë të cilat duhet të paraqesin projektet e tyre për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar si dhe veprimtari të tjera në fushën e Mbrojtjes Civile. Prioritet do të kenë projektet për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe ato me bashkëfinancim. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë afat 30 ditë të paraqesin projektet e tyre, të cilat do të vlerësohen më pas nga Komiteti për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i cili do të shpallë dhe projektet fituese.

Ministria e Mbrojtjes, katër milionë dollarë bashkive për fatkeqësitë natyrore



NATO, projekt kundër dezinformimit

NATO ka nisur një projekt, në vendet anëtare, kundër dezinformimit dhe veprimtarive armiqësore të informacionit.

Në një njoftim për shtyp, NATO bën të ditur se do të ofrojë grante për ide të reja në fushën e informacionit, duke u mundësuar vendeve të Aleancës që të jenë më elastikë ndaj dezinformimit dhe veprimtarive armiqësore të informacionit.

Teksa ka dhënë më shumë informacione për këtë nismë, Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u shpreh se: “Dezinformimi dhe veprimtaritë armiqësore të informacionit janë kthyer në një fenomen shqetësues dhe për këtë NATO është e vendosur t’i kundërpërgjigjet këtyre fushatave. Nisma më e fundit e

Aleancës është gjithashtu një mundësi e jashtëzakonshme për organizatat joqeveritare (OJF) shqiptare, universitetet, dhe çdo organizatë tjetër të shoqërisë civile. Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s ka bërë një thirrje për të mbështetur financiarisht çdo projekt novator për të luftuar dezinformimin dhe aktivitetet armiqësore të informacionit në shoqëritë tona”.

Ndaj ministri Peleshi i bën thirrje çdo OJF-je, universiteti apo organizate të shoqërisë civile në Shqipëri, me ide të reja dhe projekte inovatore, të cilët kanë afat deri më 10 maj 2022 të aplikojnë.

Peleshi: NATO mbështet financiarisht çdo projekt novator për të luftuar dezinformimin dhe aktivitetet armiqësore të informacionit në shoqëritë tona



Përrurohet Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile

Ministri Peleshi: Hapi i parë drejt ngritjes së një sistemi modern të Mbrojtjes Civile

U përruroi Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Ajo u bë e mundur falë grantit prej 1 milion eurosh, të vënë në dispozicion nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim.

Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e cilësoi këtë një investim shumë të rëndësishëm, i cili sjell një tjetër standard të lartë në shërbimin dhe menaxhimin e sistemit të Mbrojtjes Civile në Shqipëri. Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen e popullit shqiptar për angazhimin e Italisë në situata emergjente dhe kritike si ajo e tërmetit të vitit 2019, apo edhe përgjatë pandemisë COVID - 19: “Ambicia jonë është e madhe, së bashku me bashkinë e Tiranës ne jemi përkrah në këtë hap të parë që do të shoqërohet më tej, nga një program shumë më i madh prej 30 milionë eurosh, në kuadër të një ndihme prej 95 milionë eurosh, dhe këtu Italia ka rolin e liderit. Pra, kemi bërë hapin e parë për të shkuar drejt një sistemi vërtetë modern, bashkëkohor të mbrojtjes civile për t’iu përgjigjur në kohë, krah për krah me bashkitë që janë në frontin e parë me emergjencat civile, çdo lloj fatkeqësie natyrore e për të mbrojtur qytetarët tanë”, - u shpreh gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes sqaroi se: “në këtë qendër do të ketë vendin e vet çdo institucion përgjegjës për Mbrojtjen Civile dhe sapo të merret thirrja për një rast fatkeqësie, do të jetë këtu për të bashkëpunuar edhe fizikisht”.

Z. Peleshi njoftoi se falë projektit tjetër do të nisin investimet edhe në bashkitë e vendit, për të bërë të mundur një reagim të menjëhershëm dhe profesional në raste zjarresh apo përmbytjesh.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe kryetari i Dhomës Italiane, Roberto Fico, kryetari i Bashkisë, Erion Veliaj, ambasadori i Italisë në



Shqipëri, Fabrizio Buci, drejtori i Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, Luca Maestripieri dhe drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Haki Çako.

Presidenti i Dhomës Italiane Roberto Fico, vuri në dukje raportet mjaft të mira të bashkëpunimit mes dy vendeve: “Edhe Italia është një vend i

goditur nga tërmetet. Eksperienca jonë e bashkëpunimit është e shkëlqyer. Ky investim mendoj se do të shërbejë jo vetëm për të shpëtuar jetë, por edhe për të parandaluar fatkeqësi, si ajo që ndodhi në Shqipëri në 2019 dhe në Itali në disa raste. Ky është fillimi i një udhëtimi që ne do të bëjmë së bashku, i cili do të ketë disa zhvillime me synim



arritjen e standardeve europiane në fushën e Mbrojtjes Civile”.

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj tha se: “Ne duhet të jemi përditë të përgatitur sikur çdo ditë do ndodhë një gjë që ndodh në 100 vjet. Ky është definicioni i një kombi serioz”.

Drejtori i Përgjithshëm Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako shpjegoi se Qendra Kombëtare e Operacionale e Emergjencave Civile ka kapacitet për 12 operatorë nga forca të ndryshme që janë të përfshira në operacione në terren, sipas ministrive

të ndryshme, në varësi të ndodhjes dhe llojit të emergjencës. Sipas tij: “Ky inaugurim duhet të jetë fillimi i një rruge zhvillimi progresiv që do ta sjellë Shqipërinë në një shkallë të mjaftueshme autonomie në menaxhimin e emergjencave”.

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, e vendosur në një mjedis të vënë në dispozicion nga bashkia e Tiranës do të përmirësojë koordinimin dhe komunikimin e strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile në rastet e Emergjencave Civile.

Forca Tokësore organizon "Ditën e Hapur" në bashkëpunim me gjimnazin "Qemal Stafa"

Në kuadër të 13-vjetorit të anëtarësimit të vendit tonë në NATO dhe rritjes së bashkëpunimit me komunitetin civil, sot Forca Tokësore (FT) në bashkëpunim me gjimnazin "Qemal Stafa", organizoi aktivitetin "Ditë e Hapur".

Ky aktivitet, i zhvilluar në ambiente stërvitore të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore, pati si vizitorë të tij rreth 100 nxënës dhe stafin pedagogjik të njërit nga gjimnazet më të mira të Tiranës siç është gjimnazi "Qemal Stafa".

Për rreth 2 orë, gjimnazistët patën mundësinë të shikonin dhe preknin nga afër armatimin, pajisjet dhe tekniken që përdor efektivët e ROS.

Më tej, ata vizituan edhe disa prej stacioneve stërvitore siç ishin kulla e alpinizmit, fshati taktik, poligoni i qitjeve luftarake dhe këndi i mbijetesës, të cilat lanë mbresa të veçanta tek të gjithë nxënësit.

Më dëshirën e madhe, për të përjetuar adrenalinën që të jep hedhja me litar nga kulla e alpinizmit, një pjesë e tyre guxuan të bëhen pjesë e kësaj sfide.

Axhenda e "Ditës së Hapur" vijoi, edhe me një program artistik me pjesëmarrjen e këngëtarëve të Qendrës së Kulturës Mediave dhe Botimeve të Mbrojtjes, Saimir Braho dhe Redon Makashi.

Në këtë aktivitet, mori pjesë gjithashtu edhe personeli i Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), të cilët ofruan për gjimnazistët e "Qemal Stafës", informacionin e nevojshëm se si të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.



CEREMONIA

Kolonel Altin Gjetaj merr zyrtarisht detyrën e komandantit të Qendrës së Personel Rekrutimit

Kolonel Altin Gjetaj ka marrë zyrtarisht detyrën e komandantit të Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR). Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm dhe personeli i Qendrës së Personel Rekrutimit.

Në fjalën e tij gjatë prezantimit të komandantit të QPR-së, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së vlerësoi cilësitë e lidershit të kolonel Gjetajt, duke theksuar sfidat me të cilat përballon Qendra e Personel Rekrutimit dhe pritshmëritë e Shtabit të Përgjithshëm për përmirësimin e procesit të rekrutimit dhe menaxhimit të personelit të Forcave të Armatosura. Kolonel Gjetaj, nga ana e tij pasi falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm për besimin dhe mbështetjen e treguar, prezantoi objektivat e tij për reformimin e procesit të rekrutimit, përmirësimin e procedurave të menaxhimit të per-



sonelit në rezervë, si dhe shtimin e përmirësimit të shërbimit online të QPR-së në portalin e-Albania.

Në përfundim, gjeneralmajor

prof.asoc Begaj i uroi kolonel Gjetaj suksese në detyrën e re, duke e siguruar për mbështetjen e Shtabit të Përgjithshëm në të gjitha nismat e QPR në të ardhmen.

DHURIMO GJAK, SHPËTO JETË

Efektivët e Komandës Mbështetëse dhurojnë gjak për të shpëtuar jetë

Dhurimi i gjakut është një akt vullnetar, pa shpërblim. Gjaku nuk mund të prodhohet në laborator, prandaj burimi i vetëm është dhurimi i tij. Nisur nga rëndësia e këtij fakti, dhurimi vullnetar i gjakut është kthyer në një traditë të përvitshme bashkëpunimi ndërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Forcave të Armatosura.

Gjatë këtyre ditëve efektivët e Komandës Mbështetëse dhe reparteve vartëse të saj janë paraqitur vullnetarisht për të dhuruar gjak. Dhurimi i gjakut u bë në prezencën dhe kujdesin e personelit shëndetësor të qendrës shëndetësore të Komandës Mbështetëse, si dhe të personelit shëndetësor nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku. Vlen të theksohet se çdo vit Komanda Mbështetëse dhe efektivët e reparteve vartëse kanë dalë vullnetarë për dhurimin e gjakut, duke e vlerësuar atë si një gjest human dhe tepër domethënës që shpëton jetë. Nën këtë bindje, ata i janë përgjigjur gjithmonë pozitivisht, çdo thirrje dhe nevojë për të dhuruar gjak.

Në këtë proces morën pjesë rreth 44 ushtarakë nga Komanda Mbështetëse dhe repartet vartëse të saj. Përmes këtij kontributi, efektivët e Komandës Mbështetëse u solidarizuan me përpjekjet e të gjithë atyre të sëmurëve që luftojnë për jetën, pasi çdokush mund të shpëtojë jetë duke dhuruar gjak.



Aktiviteti



Ekipi i New Jersey-it viziton ANO

Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional u zhvillua aktiviteti "Albanian NCO Development Scoping Mission", me përfaqësues 3 nënoficerë, CSM Kevin Kukpatrick, MSG Jan Lumley, SFC Travis Lovell, të kryesuar nga kapiten Sean Leonard, kurse nga pala jonë morën pjesë nënoficeri i SHSH-PFA, kryekapiter Albert Koka, nënoficer i AFA-së kryekapiter Durim Valisi, nënoficer i QAPN kryekapiter Ilmi Popshini. Në ditën e parë, ekipi amerikan i New Jersey-it u prit nga komandanti i QAPN-së, kolonel Arben Toska dhe në vijim, sipas programit, u mbajt një brifing njohës mbi misionin, detyrat, përgjegjësitë dhe rolin që kryen trupa e nënoficerëve të QAPN-së dhe në tërësi në FA, si dhe zhvilluan vizitë njohëse në ambientet e QAPN-së.

Në ditën e dytë, aktiviteti vijoi me ndjekjen e procesit mësimor dhe stërvitor me kurset, duke ndjekur nga afër procesin mësimor/stërvitor.

Në fund të takimit kapiten Sean Leonard dhe komandanti i QAPN-së, kolonel Arben Toska, në shenjë respekti mes palëve, shkëmbyen dhurata institucionale.



Gjeneral brigade Pulaj jep "Certifikatë mirënjohje" për punonjës të Forcës Ajrore me rastin e daljes në pension

Gjeneral brigade Pulaj: Falënderim për përkushtimin dhe kontributin e shquar, të dhënë gjatë karrierës në Shërbimin Meteorologjik Ushtarak në Forcën Ajrore

Në mjediset e stacionit Meteorologjik Ushtarak, Tiranë, u zhvillua ceremonia e dhënies së "Certifikatës së mirënjohjes", akorduar nga komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj me rastin e daljes në pension të z. Gëzim Meçaj, i cili mbante detyrën e shefit të stacionit meteorologjik Korçë.

Mbas përshkrimit të karrierës së z. Meçaj, nga drejtuesi i stacionit meteorologjik Tiranë, Komandanti i Forcës Ajrore vlerësoi kontributin e tij si ushtarak dhe më pas si punonjës civil në Forcat e Armatosura dhe specifikisht në Forcën Ajrore.

Gjeneral Pulaj falënderoi për shërbimin dhe sakrificat, për eksperiencën e dhënë dhe profesionalizmin e treguar, duke i dorëzuar kështu z. Meçaj certifikatën me motivacion: "Falënderim për përkushtimin dhe kontributin e shquar, të dhënë gjatë karrierës në Shërbimin Meteorologjik Ushtarak, në Forcën Ajrore".

Në fjalën e tij z. Gëzim Meçaj falënderoi gjeneral brigade Ylli Pulaj për vlerësimin, duke shprehur në të njëjtën kohë emocionet e veçanta për këtë ceremoni dhe respektin e treguar me rastin e daljes në pension.



Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

Më herët, gjeneral Pulaj ka vlerësuar me "Certifikatë mirënjohje" z. Novruz Leka, z. Sokol Duka, dhe z. Hasan Myrtezaj, të cilët në të njëjtën periudhë kanë dalë në pension, duke i shprehur atyre mirënjohje për kontributin dhe përkushtimin e dhënë gjatë viteve që kanë shërbyer si pjesëtarë të Forcës Ajrore si dhe iu ka uruar atyre shëndet dhe jetë të gjatë pranë familjarëve të tyre.



Arsimimi

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, filloi kursi i 72-të Fillestar i Nënoficerit, i cili do të zhvillohet prej një periudhë 5-javore.

Në këtë kurs do të ndjekin procesin mësimor 54 kursantë me gradën UPR - IV të ardhur nga strukturat e FA-së, ku tre prej tyre janë personel femër.

Objekti i këtij kursi, është hedhja e bazave për karrierën e nënoficerit, marrja e njohurive teoretike dhe ato praktike, për drejtimin e grupit dhe niveleve të njehsuara me të, shkëputja nga përgjegjësia individuale në aftësinë dhe përgjegjësinë si drejtues grupi.

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, filloi kursi i 72-të Fillestar i Nënoficerit



"Dita e Vizitorëve të Shquar"

"Dita e Vizitorëve të Shquar" për aktivitetin trajnues të përbashkët me palën amerikane OCS CL 65 FTX. Ky aktivitet u ndoq edhe nga Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, znj. Yuri Kim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, Atasheu Ushtarak i SHBA-së, zyrtarë të Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC) etj. Gjatë "Ditës së Vizitorëve të Shquar" u demonstruan veprime të përbashkëta për kryerjen e sulmit në nivel toge si dhe tërheqjes së të plagosurve dhe dhënies së ndihmës së parë në fushëbetejë. Gjatë FTX janë zhvilluar aktivitete të integruara në nivel skuadre dhe toge ndërmjet kursantëve tanë të KPO 22 dhe kadetëve të OCS CL 65. Aktiviteti përfshinte kryesisht tema taktike dhe lidhshipi. FTX do të mbyllet me analizën pas veprimit dhe me trajnim të integruar të dy palëve të instruktorëve. Aktivitete të këtij lloji do të vijojnë edhe në të ardhmen, në kuadër të arritjes së objektivave të transformimit të AFA-së dhe sistemit të arsimimit profesional ushtarak.

Zhvillohet aktiviteti "Dita e Vizitorëve të Shquar"



TAKIM KUSHTUAR 26-VJETORIT TË KRIJIMIT TË SHKURSH

Në ambientet e auditoriumit u organizua 26-vjetori i krijimit të Shoqatës së Ushtarakeve në Rezervë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin dhe përfaqësues të kësaj shoqate nga rrethet e ndryshme të Shqipërisë. Presidenti i shoqatës z. Thoma Konduri, pasi falënderoi pjesëmarrësit, kujtoi vështirësitë që ka kaluar në këto vite rrugëtimi kjo shoqatë dhe mbështetjen e gjerë që ka gjetur ajo në të gjithë Shqipërinë. Më pas fjalën e mori presidenti i nderit zoti Zydi Kroj, i cili solli kujtime nga çastet kur kjo shoqatë po hidhte hapat e saj të parë.

Liliana Konomi Mero, si përfaqësuese e ish-ushtarakeve femra falënderoi për bashkëpunimin dhe mjedisin e ngrohtë të krijuar në rrugëtimin e tyre të përbashkët.

Z. Bujar Shtylla solli një sintezë të punës së bërë në këtë periudhë mbi çerekshekullore.

“Të jesh veteran i Ushtrisë është një titull nderi”, -ishin fjalët e z. Sali Onuzi, i cili me tej do shprehej se:

“Puna e Shoqatës sonë, sidomos në aspektin e të drejtave ekonomike të ushtarakëve në rezervë, ka qenë një punë e madhe, e vështirë, heroike. Me shumë mund e sakrificë, ajo ia ka dalë të jetë një mbrojtëse e të drejtave tona. Por ne nuk jemi thjesht një shoqatë që kujdeset vetëm për çështjet e saj organizative, duke bërë një punë të mbyllur. Usharakët kanë treguar që në vitet e para të reformave, disa nga të cilat prekën rëndë të drejtat e tyre dhe të popullit, se ata nuk pajtoheshin me padrejtësitë. Le të kujtojmë këtu përballimin e situatës së rëndë që kapi vendin në vitet 1996-1998.

Shoqata jonë ka qenë e është edhe një subjekt aktiv i edukimit patriotik të anëtarëve të saj dhe ndikimi në shoqërinë shqiptare. Ashtu siç nuk ka ushtri pa edukim patriotik, edhe shoqata jonë nuk mund të bëjë pa këtë. Oficeri aktiv e ne rezervë është i lidhur ngushtë me Atdheun, me lirinë dhe pavarësinë e tij. Ky edukim patriotik është një armë e fuqishme.

Ne po e shohim se ç’ ndodh në Ukrainë. Qëndresa e saj është mburje për të gjithë, me patriotizëm, të një populli që lufton e qëndron për atdheun e lirinë e tij, me një udhëheqje e një president që janë bërë shembull patriotizmi anekënd Botës, kundër një ushtrie të armatosur deri në dhëmbë, por që kishte mbivlerësuar rolin e teknologjisë së lartë ushtarake. Dje ishte 7 prill, dhe është rasti të kujtojmë po edhe të rivlerësojmë më tej shembullin negativ të ish-mbretit, Ahmet Zogut, që as dy ditë nuk qëndroi në Shqipëri pas sulmit dhe pushtimit fascist Italian.

Pas luftës në Ukrainë është krijuar e po krijohet një situatë tjetër gjeopolitike dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo luftë e ashpër nuk dihet se si dhe kur do të përfundojë. Ajo është një rrezik që mund të ndezë konflikte edhe më të mëdha. Në këto situata, detyra jonë është të jemi të bashkuar, të jemi përkrah Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm, përkrah shtetit tonë shqiptar, për të përballuar çdo situatë, qoftë ekonomike, politike apo edhe ushtarake. Nuk duhet ta nënvlefësojmë punën tonë në këtë drejtim, duke menduar se jemi në pension e lirim e jemi të moshuar. Ne jemi betuar se sa të jemi gjallë do të jemi në këmbë për Shqipërinë, do të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi, edhe me përvojën tonë, edhe me aftësitë tona, po edhe

"Të jesh veteran i Ushtrisë është një titull nderi"



me fjalën e urtë, që me të drejtë Homeri e llogariste si tiparin më thelbësor të të moshuarve. Këta që drejtojnë Shqipërinë sot janë shokët po edhe djemtë e vajzat tona, nipërit e mbesat tona. Ka shumë rëndësi t'u jemi pranë atyre me këshilla, mendime e çdo gjë që situata mund të ketë nevojë.

Por, edhe të dimë të përçojmë në masën e njerëzve arritjet e Shqipërisë së sotme, si një vend i NATO-s, që vjet pati presidencën e OSBE-së dhe tani, për dy vjet është e do të jetë anëtar i Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që është bashkë-penëmbajtës aty me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ka dërguar reparte ushtarake në përbërje të trupave të NATO-s, ku ka qenë e nevojshme, që priti me bujari vëllezërit

e motrat e tij, shqiptarë të Kosovës më 1999 dhe strehon ish-luftëtarët iranjanë, emigrantët afganë, dhe tani edhe ato ukrainas, duke u siguruar kushte sa më të mira dhe duke u bërë shembull pozitiv edhe për disa vende të pasura të Botës.

Ky edukim patriotik kërkon që ne veteranët e ushtrisë të jemi edhe më aktivë në mbrojtjen e historisë së LANÇ dhe të historisë së Ushtrisë sonë populllore dhe të Forcave të Armatosura sot, përkundër disa qëndrimeve nihiliste dhe antihistorike, që artikulojnë disa tipa tashmë të njohur për negativizmin e tyre. Ushtria jonë ka pasur edhe drejtues dhe historianë të zotë. Po edhe në kohën tonë Shqipërisë sonë nuk i mungojnë ata. Madje po shtohen, krahas

një brezi të vjetër (anëtarë të Institutit të studimeve të Historisë ushtarake, të drejtuar nga prof. dr. Proletar Hasani) kanë ardhur në skenë shkencëtarë të rinj si Marenglen Kasmi, Kristaq Xharo (me shkrimet e tij studimore për aspekte të veçanta të sigurisë) po dhe autorë të rinj ushtarakë si Zeno Jahaj, Agron Berdaj, (me librin e tyre “Përtej shtrembërimeve: Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare”), pedagogia e Historisë Ushtarake të Akademisë së FA-së, znj. Enkeleida Tyrku, ose Dilaver Goxhaj, shoku ynë që luftoi e drejtoi në radhët e UÇK-së, që shkruan vazhdimisht, dhe vetëm javën e fundit dy artikuj në “Dita”, për luftën e Selenicës në 1943 (duke nxjerrë në shesh gënjeshtat e ballistëve dhe luftën e çetave partizane) dhe për vlerën e fortifikimit të dikurshëm, që e sulmuan ultrapacifistët (si të panevojshëm e të dëmshëm) dhe që e shkatërruan pa dhimbje individualistë e arrivistë për mikropërfitime, ndofta edhe për dëmtime të qëllimshme armiqësore. Unë besoj se organet kompetente do të interesohen që ato Qendra Zjarri që kanë shpëtuar të mirëmbahen e ruhen, t'i kemi për çdo të papritur e kundër çdo rreziku. Ato, siç thotë populli, nuk kërkojnë ujë e bukë.

Ja, po shohim se sa i rëndësishëm

është fortifikimi në Ukrainë: banorët u futën nëpër metro e podume të pallateve për t'i shpëtuar bombardimeve të ushtrisë pushtuese ruse. Po nuk shikon nga ato që japin mediat, të ketë e të shfrytëzohen fortifikime moderne, shihen vetëm disa qendra zjarri si ato të luftës së parë e të dytë botërore, ndërtuar shpejt e shpejt, me drurë e dhe, dhe ku?, në një vend fushor, ku fortifikimi do të bënte shumë punë. Historia ushtarake është laborator i oficerit, thonë filozofët e Luftës e të ushtrive. Ajo duhet shkruar po dhe studiuar me kujdes për të përfutur përvojë, kulturë dhe aftësi drejtimi e luftimi. Prandaj mendoj se Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së duhet ta rishikojnë programin e historisë e të gjeografisë ushtarake në Akademinë tonë të FA-së, por edhe në kurset e ndryshme të kualifikimit. Në këto drejtime të edukimit atdhetar ne mund e duhet të bashkëpunojmë me ngushtë me Organizatën e Veteranëve e të pasardhësve të LANÇ-it (“Nderi i Kombit”) dhe me Organizatën Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut, që kanë një përvojë të pasur shumëvjeçare. Në mbyllje u shpërndanë “Certifikata Mirënjohjeje” për gjithë kontributorët e kësaj shoqate.

Vizita

Anëtarë të Kryesisë së Shoqatës “Detaria Shqiptare”, ish-komandantë të Flotës Detare, bashkë me përfaqësuesit e shoqatës “Detaria Shqiptare”, zotin Bujar Bardhi, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, të cilët u pritën nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra dhe disa kuadro të shtabit.

Fillimisht veteranët e Flotës i uruan suksese në detyrën e komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastrës, bashkë me personelin e Forcës Detare.

Gjithashtu kundëradmiral Agastra u uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare dhe i siguroi se komanda e Forcës Detare do jetë e hapur vazhdimisht për të gjithë ata që kanë shërbyer në Flotën tonë Detare.

Gjatë takimit ish-komandantët u njohën me punën që po bëjnë aktualisht efektivët e Forcës Detare për realizim e detyrave të përditshme në të cilën sollën përvojën e tyre në çështje të caktuara.

Gjithashtu komandant Agastra

Përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve të Flotës Detare “Detaria Shqiptare” realizuan një vizitë në Komandën e Forcës Detare



i njohu miqtë e Forcës Detare me disa synime kryesore që kanë të bëjnë me reformimin dhe modernizimin e Forcës Detare. Veteranët shprehën kënaqësinë e tyre për çdo arritje të Forcës sonë Detare.

Për punën, aktivitetin dhe bashkëpunimin e shoqatës “Detaria Shqiptare”, në ruajtjen dhe transmetimin e traditës së detarëve, komandant Agastra i akordoi shoqatës “Certifikatë Mirënjohjeje”.



Pas pushtimit rus të Ukrainës, fëmijët atje po përjetojnë pasojat shkatërruese të të jetuarit në një zonë lufte – kërcënimin e vazhdueshëm të granatimeve, të shtënave dhe humbjes së njerëzve të dashur, si dhe shqetësimin për aksesin në ushqim, ujë të pijshëm të pastër dhe kujdes shëndetësor.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kanë frikë se vriten,
nënat ukrainase u shënojnë
fëmijëve të dhënat në trup

Lajm që mbushi faqet e çdo medie vizive apo të shkruar. Lajme rrëqethëse që nuk dimë ende sa do të zgjasin? Kthejmë sytë nga qielli të gjithë ne, që besojmë tek një forcë hyjnore, sepse “tokësorët” i ka verbuar pangopësia, (karakteristikë e epokës së hershme nga vijnë).

Sa e brishtë historia?

Si në një celuloid të shfaqen regjitet e filmave me arsenal armësh apo njerëz të tretur në eter, rrugë të lara nga gjurmë gjaku, lodra fëmijësh, mbetur në cepa pallatesh pa adhuruesit e tyre.

Kjo është një epoke e re?!

Në vlera numrash kemi ecur në rend rritës, por a ndryshon historia e kohëve moderne nga ajo e shekujve të mëparshëm?

Thjesht kemi përsëritur veten në dimensione edhe më shtazarake. **“Luftë mes llojit”**

Pas pushtimit rus të Ukrainës, fëmijët atje po përjetojnë pasojat shkatërruese të të jetuarit në një zonë lufte – kërcënimin e vazhdueshëm të granatimeve, të shtënave dhe humbjes së njerëzve të dashur, si dhe shqetësimin për aksesin në ushqim, ujë të pijshëm të pastër dhe kujdes shëndetësor.

“Holokausti” në kurrizin e njomë të fëmijëve ukrainas?

Shkruar emri, mbiemri, data e lindjes, sepse e nesërmja nuk dihet se çfarë sjell për fatin e tij. Sepse e drejta e fëmijëve për të jetuar dhe që juridikisht përfaqësuesit e gjithë shteteve kanë firmosur mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijëve për një botë të paqë dhe të bukur po shkel fuqishëm me këmbë çdo parim të firmosur me dorë.

“Trashëgimia e kësaj lufte do të jetë një brez i traumatizuar”

Nëpërmjet një statusi në rrjete sociale, Ambasada Amerikane njofton se nga lufta në Ukrainë janë vrarë 183 fëmijë dhe 342 të tjerë janë plagosur. “Pas çdo vdekjeje të një fëmije, nëna, babai apo familja ndryshon përgjithmonë. Çdo atentat u krye nga një ushtar, komandant rus dhe Vladimir Putin, krimet e të cilit nuk do të harrohen. Lufta është ndezur, askush nuk e di se cila ishte drita e fundit e hënës dhe ende njerëzit nuk bërtisin nën shpërthimin e predhave: “Stop! Jo!”. Lufta po vazhdon dhe tanket do të lëvizin dhe njerëzit...

Drama e një lufte dhe “kthetrat e ferrit” që po përpijnë njerëzimin



Lufta është gjëja më e keqe që mund të ndodhë në jetën e çdo njeriu. Ajo mbart shumë frikë, dhimbje, britma, klithmat e nënave, fëmijëve, bashkëshorteve, humbje të njerëzve të dashur ...

Sa fëmijë la jetimë, dhe të veja me shami të zeza në kokë. Sa kujtime të tmerrshme ajo la pas në kujtesën njerëzore.

Pas?! Apo aty ka qenë gjithmonë?

Lufta është dhimbja e fateve njerëzore, e shkaktuar nga ata që sundojnë në krye dhe e dëshirojnë pushtetin në çdo mënyrë, qoftë edhe të përgjakshme.

Lufta e Madhe Patriotike me të drejtë

mund të quhet e shenjtë. Në fund të fundit, të gjithë njerëzit u ngritën për të mbrojtur atdheun e tyre, ashtu si populli ukrainas sot po mbron atdheun e tij, duke mos pasur frikë nga një plumb endacak, mundim, robëri dhe shumë më tepër. Paraardhësit tanë u mblodhën aq shumë dhe shkuan përpara për të rimarrë vendin e tyre nga armiku, në të cilin ata lindën dhe u rritën. Për brezin e ri Lufta e Madhe Patriotike është vetëm një histori nga e kaluara e largët. Por kjo histori trazon gjithçka brenda dhe të bën të mendosh për atë që po ndodh në botën moderne. Mendoni për luftërat që shohim tani. Mendoni se nuk duhet të lejojmë një luftë tjetër dhe

t'u vërtetojmë ushtarëve heroikë se jo më kot po bien për atë tokë, se jo më kot u lag dhe me gjakun e tyre! Unë dua që të gjithë të kujtojnë koston e kësaj Fitoreje jo të lehtë dhe pagën që duket se po cenohet mbi kokën tonë!

Dhe atëherë nuk do kemi më nevojë për laps dhe letër se bilancet njerëzore do i bëjmë me gishtat e njërës dorë.

S'mjafton një ditë për të kujtuar, duhet dhe e nesërmja...

I dashur vogëlush, ti mund të bësh shumë që lufta të përfundojë dhe paqja të kthehet. Ti mund t'i tregosh botës se

është e mundur të jemi miq, pavarësisht se të ndryshëm. Në klasë, për shembull, ke një fëmijë me ngjyrë të ndryshme lëkure, por e ke shok. Ke një tjetër që flet ndryshe, nuk e kupton, por e ke shok. Mund t'i tregosh botës se të merresh vesh me tjetrin nuk do të thotë të kesh të njëjtën ide me të. Mund të ndodhë që njëri nga shokët ka ide të tjera e grindesh me të, por, pastaj, bëni paqe menjëherë. Mund të bësh paqe duke i thënë shokut të mos zemërohet, se përndryshe do të trishtoheni të dy. Kur bëjmë paqe, jemi të lumtur! Mund edhe të ndërhysh kur një shok grindet me dikë e ta bësh të qeshë, duke e bërë fytyrën qesharake, ose duke i thënë një fjalë gazmore.



STATISTIKA

Ambasada Amerikane njofton se nga lufta në Ukrainë janë vrarë 183 fëmijë dhe 342 të tjerë janë plagosur. “Pas çdo vdekjeje të një fëmije, nëna, babai apo familja ndryshon përgjithmonë. Çdo atentat u krye nga një ushtar, komandant rus dhe Vladimir Putin, krimet e të cilit nuk do të harrohen. Lufta është ndezur, askush nuk e di se cila ishte drita e fundit e hënës dhe ende njerëzit nuk bërtisin nën shpërthimin e predhave: “Stop! Jo!”. “Stop! Jo!”.



MSC. MIMOZA GOLIKJA

Më 13 prill 2020, NATO njoftoi se pavarësisht ndikimit të pandemisë, Organizata e Shkencës dhe Teknologjisë e NATO-s (STO) ofroi me këmbëngulje Programe të shkëlqyera të Punës (PoWs) falë rrjetit të saj prej mbi 5 000 shkencëtarësh, inxhinierësh dhe analistësh. Kjo siguron që STO të mbetet në pararojë të S&T dhe është e përkushtuar për të mbështetur avantazhin teknologjik të NATO-s, Aleatëve dhe Partnerëve në një botë gjithnjë e më konkurruese.

STO ka shpërndarë publikisht tre raporte për vitin 2022, që nxjerrin në pah arritjet e saj depërtuese dhe përkrahja e rrugën për të ardhmen.


“Refleksionet e STO 2021”, është njëri prej tyre, që ilustron ndikimin dhe rëndësinë e POW-ve të STO-së për Aleancën, duke mbuluar Qendrën për Kërkime dhe Eksperimentim Detar (CMRE) PoW dhe Bashkëpunues PoW (CPoW). Kjo përfshin mbi 300 aktivitete që variojnë nga programet kryesore kërkimore deri te skanimi i horizontit dhe seritë e leksioneve, si dhe demonstrimi bashkëpunues i teknologjive.

Raporti synon të jetë si një përmbledhje e projekteve dhe arritjeve të përfunduara së fundmi si në CMRE ashtu edhe në PoW 2021. Ai gjithashtu përmbledh këshillat e prodhuara për udhëheqjen e NATO-s për të ndihmuar vendimmarrjen e nivelit të lartë për tema vendimtare si “Gratë në Forcat e Armatosura”, “Kërcënimet dhe rreziqet CBRN”, “Teknologjitë në zhvillim dhe shkatërruese (EDT)”, “Ndryshimet klimatike dhe tendencat S&T 2020-2040”. Misioni i CMRE është të organizojë dhe kryejë kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik, të përqendruar në fushën detare, duke ofruar zgjidhje novatore dhe të testuara në terren të Shkencës dhe Teknologjisë (S&T) për të adresuar nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës.

Raporti Vjetor 2021 CMRE thekson nga ana e tij aktivitetet e CMRE-së në ekzekutimin e programit të saj të punës për vitin 2021 dhe arritjet në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar për klientët e saj, dhe në veçanti për Komandën Aleate të NATO-s për Transformimin sipësjeshë e programit Detar S&T me fokus në kundërmasa autonome të minave detare; autonomi për luftën kundër nëndetëseve; njohuritë e të dhënave mjedisore dhe efektiviteti operacional; dhe mundësuesit e sistemeve detare pa pilot. Raporti vjetor ilustron se si shkencëtarët, inxhinierët dhe teknologët e CMRE shfrytëzojnë teknologjitë në zhvillim dhe përçarës në mënyra inovative për të ruajtur avantazhin teknologjik të NATO-s. Programi i Punës Bashkëpunuese 2022, është gjithashtu një program tjetër që ofron një përmbledhje të projekteve të Organizatës së Shkencës dhe Teknologjisë (STO) të planifikuara për vitin 2022 në kërkimin dhe zhvillimin teknologjik të mbrojtjes dhe sigurisë për aftësitë e zgjeruara ushtarake operationale për

INFORMIM I VENDIMMARRËSIT PËR SFIDAT DHE MUNDËSITË NË ZHVILLIM

Fuqizimi i avantazhit teknologjik të NATO-s



Kombet dhe NATO-n. “CPoW 2022” përbëhet nga 283 aktivitete kërkimore teknike të vazhdueshme dhe të planifikuara dhe 49 ekipe eksploruese.

CPoW është një mjet i krijuar për t'iu përgjigjur nevojave të Kombeve dhe kërkesave të NATO-s. Prandaj, ndërtimi i tij bazohet në orientimin strategjik të ofruar nga Kombet, Panelet/Grupet gjatë takimeve të tyre të biznesit dhe organizata më e lartë e centralizuar e NATO-s. Në fund të fundit, Kombet, përmes Bordit të Shkencës dhe Teknologjisë (STB), mbeten autoriteti kolektiv që vendos se si duhet të zhvillohet CPoW. Projektet kërkimore CPoW, të menaxhuara nga Zyra e Mbështetjes së Bashkëpunimit STO (CSO) në Paris, Francë, do të kryhen në të gjitha fushat aktuale të CpoW: Teknologjia e Aplikuar e Automjeteve (AVT); Faktorët Njerëzorë dhe Mjekësia (HFM); Teknologjia e Sistemeve të Informacionit (IST); Analiza dhe Studimet e Sistemit (SAS); Konceptet dhe Integrimi i Sistemeve (SCI); Sensorët dhe Teknologjia Elektronike (SET); si dhe Modelimi dhe Simulimi (NMSG).

Nga ana tjetër për vitin 2022, shumë projekte CPoW vazhdojnë të përqendrohen në aplikimet dhe implikimet e Teknologjive në zhvillim dhe përçarjeje të NATO-s, si inteligjencë artificiale, autonomi, të dhëna të mëdha, bioteknologji, hipersonikë, shkencë kuantike, hapësirë dhe materiale të reja.

Rreth Organizatës së NATO-s për Shkencë dhe Teknologji (STO)

Organizata e NATO-s për Shkencë dhe Teknologji (STO) ofron inovacione, këshilla dhe zgjidhje shkencore për të përmbushur nevojat gjithnjë në ndryshim të Aleancës. Ajo siguron që NATO të ruajë avantazhin e saj ushtarak dhe teknologjik për t'u përballur me sfidat aktuale dhe të ardhshme të sigurisë. STO është forumi më i madh kërkimor bashkëpunues në botë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ai mbështet qëndrimin e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës dhe partnerëve të saj nëpërmjet kërkimit shkencor dhe teknologjik. Ka një komunitet prej më shumë se 6 000 shkencëtarësh të angazhuar në mënyrë aktive. Rrjeti STO bazohet në ekspertizën e më shumë se 200 000 njerëzve në vendet aleate dhe partnere. Programi i tij vjetor i punës përfshin mbi 300 projekte që mbulojnë një gamë të gjerë fushash si sistemet autonome, lufta kundër nëndetëseve, automjetet hipersonike, radarët kuantikë dhe ndikimi i mediave sociale në operacionet ushtarake.

Me detyra të qarta dhe përgjegjësitë e saj kryesore, STO gjeneron dhe shfrytëzon një program pune të avancuar të shkencës dhe teknologjisë, duke dhënë rezultate dhe këshilla në kohë që avancojnë aftësitë mbrojtëse të aleatëve, partnerëve dhe NATO-s në mbështetje të detyrave thelbësore të mbrojtjes kole-

tive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese. Ai gjithashtu mbështet vendimet e marra në nivel kombëtar dhe të NATO-s duke ofruar këshilla për Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe udhëheqjen kombëtare. Siç theksohet dhe më sipër STO e arrin misionin e saj nëpërmjet një numri prej më shumë se 6 000 shkencëtarësh të cilët janë të angazhuar në mënyrë aktive. Po ashtu rritet numri i ekspertizës së STO bazohet në ekspertizën e më shumë se 200 000 njerëzve në vendet aleate dhe partnere. Struktura e STO-së drejtohet nga Bordi i Shkencës dhe Teknologjisë i NATO-s (STB). Bordi administron komitetet shkencore dhe teknike të STO-së dhe tre organet e tij ekzekutive si Qendrën për Kërkimin dhe Eksperimentimin Detar (CMRE) në La Spezia, Itali; Zyrën e Mbështetjes së Bashkëpunimit në Paris, Francë; dhe Zyrën e Shefit të Shkencëtarëve në Shtabin e NATO-s në Bruksel, Belgjikë. Shkencëtari kryesor është kryetar i STB-së dhe këshilltar i lartë shkencor i Këshillit të Atlantikut të Veriut. Komitetet shkencore dhe teknike, të përbëra nga anëtarë nga organet kombëtare dhe të NATO-s, drejojnë dhe ekzekutojnë aktivitetet bashkëpunuese të shkencës dhe teknologjisë së NATO-s. CMRE organizon dhe kryen kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik, të përqendruar në fushën detare, duke ofruar zgjidhje inovatore për të adresuar nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës. CMRE kryen gjithashtu kërkime

kime shkencore dhe inxhinierike praktike për përfitimin e drejtpërdrejtë të NATO-s dhe klientëve të tillë si subjektet kërkimore dhe industria. Qendra operon me dy anijet kërkimore të NATO-s që mundësojnë eksplorimin dhe zhvillimin e zgjidhjeve shkencore dhe teknologjike në det. Kjo lejon që kërkimi unik dhe i specializuar të kryhet në fushat kryesore me interes për NATO-n. Aftësia inxhinierike e CMRE mundëson shfrytëzimin e shpejtë të prototipave të konceptit për përdorim në prova dhe eksperimente ushtarake. Qendra ka gjithashtu një bazë njohurish shkencore dhe inxhinierike të përbërë nga një platformë shkencore dhe botime të dedikuara, për përdorim në të gjithë NATO-n. NATO thotë se për të mbrojtur lirinë dhe vlerat e përbashkëta të Aleancës, është me rëndësi kritike për vetë NATO-n dhe vendet partnere të saj të ruajnë avantazhin në mbrojtje dhe siguri. Zbulimi, zhvillimi dhe përdorimi i njohurive të avancuara dhe shkencës dhe teknologjisë më të avancuar janë thelbësore për ruajtjen e avantazhit teknologjik që u ka mundësuar forcave të Aleancës të kenë sukses në të gjithë spektrin e operacioneve gjatë dekadave të fundit.

STO u krijua nëpërmjet shkrirjes së Organizatës së Kërkimit dhe Teknologjisë dhe Qendrës së Kërkimit Nënutor të NATO-s. Këto organe u mbledhën pas një vendimi në Samitin e NATO-s të vitit 2010, në Lisbonë, për të reformuar strukturën e agjencisë së NATO-s. STO, së bashku me organizatat e tij paraardhëse, ka qenë instrumentale në mundësimin e këtij suksesi, si brenda kombeve ashtu edhe për vetë NATO-n. Prandaj NATO thekson se duke ofruar një vend kritik për zhvillimin dhe shpërndarjen e njohurive, STO mbetet e përkushtuar ndaj parimit të saj themelor që është bashkimi i ekspertëve të çështjeve nga i gjithë spektri shkencor me përdoruesit përfundimtarë ushtarakë, në mënyrë që të informojë vendimmarrësit për sfidat dhe mundësitë në zhvillim dhe për të siguruar avantazhin teknologjik të Aleancës dhe partnerëve të saj.

NATO mpreh avantazhin teknologjik me iniciativa inovative

Aleatët e NATO-s njoftojnë se e kanë filluar iniciativën novatore për të mprehur avantazhin teknologjik të Aleancës. Ministrat e Jashtëm aleatë miratuan Kartën e Përshpejtuesit të Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut, DIANA. “Duke punuar me sektorin privat dhe akademinë, aleatët do të sigurojnë që ne të mund të shfrytëzojmë teknologjinë më të mirë për sigurinë transatlantike”, -ka thënë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

Përshpejtuesi i Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut (DIANA) do të përqendrohet në teknologjitë e thella, ato teknologji në zhvillim dhe shkatërruese që NATO i ka identifikuar si prioritet.

DIANA do të sjellë personelin e mbrojtjes së bashku me

kompanitë fillestare më të mira dhe më të zgjuara të Aleancës, studiuesit shkencorë dhe kompanitë e teknologjisë për të zgjidhur sfidat kritike të mbrojtjes dhe sigurisë. Inovatorët që marrin pjesë në programet e DIANA-s do të kenë akses në rrjetin e saj të dhjetëra vendeve të përshpejtuesve dhe qendrave të testimit në më shumë se 20 aleatë. Udhëheqësit e NATO-s kanë rënë dakord që DIANA të kishte një zyrë rajonale në Europë dhe në Amerikën e Veriut. Zyra rajonale europiane e DIANA-s u zgjodh nga një ofertë e përbashkët Estoneze-Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja po kërkon në mënyrë aktive të presë zyrën rajonale të Amerikës së Veriut. DIANA do të përqen-

drohet në teknologjitë e thella, ato teknologji të reja dhe përçarëse që NATO i ka identifikuar si prioritet, duke përfshirë: inteligjencën artificiale, përpunimin e të dhënave të mëdha, teknologjitë e aktivizuara kuantike, autonominë, bioteknologjinë, materialet e reja dhe hapësirën. Aleatët kanë rënë gjithashtu dakord për një kornizë për një Fond shumëkombësh të Inovacionit të NATO-s. Ky është fondi i parë në botë i kapitalit sipërmarrës shumë-sovran. Ajo do të investojë 1 miliard euro në start-up, në fazat e hershme dhe fonde të tjera të teknologjisë së thellë në përputhje me objektivat e saj strategjike.

POLICIMI AJROR I NATO-S

Avionë luftarakë nga Holanda dhe Britania e Madhe marrin policimin ajror mbi Bullgari dhe Rumani

Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar morën kontrollin e zgjeruar ajror të NATO-s mbi aleatët e Detit të Zi, Bullgarinë dhe Rumaninë, në fillim të kësaj jave. Avionët “Tajfun” të Mbretërisë së Bashkuar po zëvendësojnë avionët “Eurofighters” italianë në Rumani dhe avionët luftarakë amerikanë “F-16” vazhdojnë të përforcojnë qëndrimin e forcës së Aleancës në vend. E ndërkohë në Bullgari, avionët luftarakë holandezë “F-35” po marrin kontrollin nga avionët “Eurofighters” spanjoll. Në vitet e fundit, një numër aleatësh kanë ndihmuar Bullgarinë dhe Rumaninë për të garantuar sigurinë e hapësirës së tyre ajrore. Përveç mbajtjes së sigurt të aleatëve, pjesëmarrja në këtë mision të përbashkët rrit aftësinë dhe ndërveprueshmërinë e forcave ajrore aleate.

Më 6 Prill 2022, katër avionë luftarakë “F-35”, të Forcave Ajrore Mbretërore të Holandës, u ulën në bazën ajrore “Graf Ignatievo” pranë Plovdivit, Bullgari, për të mbrojtur qiejt me Forcat Ajrore Bullgare në prill dhe maj.

I autorizuar nga një vendim i qeverisë bullgare dhe bazuar në një ofertë të Holandës për NATO-n, avionët luftarakë të gjeneratës së pestë mbështesin përgjigjen kolektive të NATO-s ndaj pushtimit të paligjshëm të Rusisë në Ukrainë. Për herë të parë, avionët luftarakë holandezë “F-35” vendosen në Bullgari nën misionin e përmirësuar të policisë ajrore, duke u integruar me aktivitetet e zgjeruara të vigjilencës së Aleancës në hapësirën ajrore të aleatëve të saj lindorë.

Aleatët e NATO-s vendosën të fillojnë këtë mision mbrojtës në vitin 2014 duke siguruar anëtarët në krahun lindor të Aleancës pas aneksimit të Krimesë nga Rusia. Që atëherë disa aleatë e kanë mbështetur këtë mision duke u partnerizuar me Forcën Ajrore të Bullgarisë në baza rotacioni.

Dislokimi aktual i Forcave Ajrore Mbretërore të Holandës integrohet me rigjallërimin e këtij misioni dhe ofron aftësi të avancuara ajrore duke nënvizuar një qëndrim të fortë dhe të aftë ushtarak për të penguar dhe mbrojtur.

“Pjesëmarrja, së bashku me kolegët tanë nga Forca Ajrore Mbretërore, e Holandës në zbatimin e misionit të policisë ajrore me avionë luftarakë “F-35” dhe avionë luftarakë bullgarë “MiG-29” është në interes të aftësive të vendeve të krahut lindor të NATO-s, përfshirë Republikën e Bullgarisë, për të siguruar sovranitetin ajror”, -tha komandanti i bazës ajrore “Graf Ignatievo”, gjeneral brigade Nikolaj Rusev.

“Megjithatë, kontributi i aktiviteteve tona të përbashkëta është shumë më i madh, ka të bëjë me ndërtimin dhe forcimin e besimit tonë të ndërsjellë si aleatë të NATO-s, shton shkëmbimin e përvojës profesionale dhe ndihmon në zgjerimin e kapaciteteve tona për ndërveprim nëse lind një nevojë e

tillë”, -shtoi ai.

“Është e rëndësishme që aleatët e NATO-s të qëndrojnë së bashku dhe unë jam krenar që ne mund t'i sjellim “F-35”-at tanë në Bullgari dhe të mbështesim aleatin tonë në mbrojtjen e hapësirës ajrore bullgare së bashku”, -tha nënkoloneli Guido Schols, komandant i njësies

holandeze “F-35” në “Graf Ignatievo”.

Forcat Ajrore Bullgare kanë kryer së bashku detyrat e Policisë Ajrore të NATO-s me Forcën Ajrore të SHBA-së në 2014 dhe 2016, Forcën Ajrore Italiane në 2017 dhe së fundmi, në 2022 me Forcën Ajrore Spanjolle. Që nga

viti 2012 e deri më sot, Forcat Ajrore Bullgare kanë kryer një numër të konsiderueshëm operacionesh ndërkufitare me Forcat Ajrore Helenike dhe Forcat Ajrore Rumune, njofton Zyra e Marrëdhënieve Publike të Komandës Ajrore Aleate.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Rob Bauer, vizitoi Republikën e Koresë, nga 9 deri më 12 Prill 2022, për të diskutuar mbi partneritetin midis Republikës së Koresë dhe NATO-s dhe se si të dy palët mund të nxisin një bashkëpunim më të ngushtë ushtarak.

Admirali Bauer udhëtoi për në Republikën e Koresë me ftesë të Kryetarit të Shefave të Përbashkët të Shtabit, gjeneral Won In-choul. Në fillim të vizitës në vend, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiral Bauer, vizitoi Varrezat Kombëtare të Seulit dhe Observatorin Dora që ndodhet në pikën më veriore të vijës së demarkacionit ushtarak në Zonën e Çmilitarizuar Koreane. Në takimet e tij me ministrin e Mbrojtjes, z. Suh Wook dhe kryetarin e Shefave të Shtabit të Përbashkët, gjeneral Won In-choul, Admiral Bauer diskutuan mbi vlerën e punës me partnerë demokratikë me mendje të njëjtë dhe se si mund të rritet ndërveprueshmëria ndërmjet NATO-s dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Koresë së Jugut. Bisedat u fokusuan veçanërisht në sfidat aktuale dhe ato në zhvillim të sigurisë, duke përfshirë armët e shkatërrimit në masë dhe mbrojtjen kibernetike; si dhe promovimin e shkëmbimit të informacionit. Në muajt e ardhshëm, të dy kryesuesit do të kenë stafet e tyre

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s viziton Republikën e Koresë

duke punuar drejt një bashkëpunimi të prekshëm dhe të zbatueshëm.

Për partneritetin midis Republikës së Koresë dhe NATO-s, Kryesuesi deklaroi se burrat dhe gratë që shërbejnë në Forcat e Armatosura të Aleatëve të NATO-s janë të rrënjësuar në të njëjtin përkushtim si njerëzit në Forcat e Armatosura të Koresë së Jugut.

“Ne të gjithë po punojmë për t'i shërbyer një të mire më të madhe: mbrojtjen e lirisë dhe demokracisë. Ajo detyrë, ai synim jetësor, formon një lidhje të padukshme që kapërcen luftërat, brezat dhe madje edhe kontinentet.”

Gjatë vizitës së tij, Kryetari Bauer u angazhua edhe në një takim me gjeneralin amerikan La Camera, i cili është komandant i Komandës së Kombeve të Bashkuara, Komanda e Forcave të Kombinuara të ROK / SHBA, Forcat e Shteteve të Bashkuara në Kore. Admirali përsëriti në angazhimet e tij se NATO mbështet plotësisht qëllimin e një denuklearizimi të plotë, të verifikueshëm dhe të pakthyeshëm të Gadishullit Korean: “NATO është

e përkushtuar ndaj një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ne jemi të etur të punojmë me partnerë demokratikë, për t'u siguruar që forca e ligjit të mbizotërojë mbi ligjin e forcës”, -tha Admirali Bauer.

Më 12 prill 2022, Admirali Bauer mbajti një leksion kryesor në Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare. Ai theksoi përfitimet e ndërsjella të partneritetit politik dhe ushtarak midis NATO-s dhe Republikës së Koresë dhe theksoi rolin udhëheqës teknologjik të vendit: “Miqësia është një koncept i fuqishëm, si për vendet ashtu edhe për njerëzit individualë. Kjo ju lejon të mbijetoni dhe të lulëzoni. Miqësia mes NATO-s dhe Republikës së Koresë është tashmë 17-vjeçare. Ka qenë e dobishme reciproke, si në planin politik ashtu edhe në atë ushtarak. Mezi pres të shoh se ku mund të na çojë miqësia jonë në të ardhmen. Unë kam çdo besim se së bashku kemi atë që duhet për t'u siguruar që liria të fitojë mbi shtypjen”.



“Solidariteti i vendeve, kompanive dhe njerëzve në mbarë botën ofron pak dritë në këtë orë të errët. Fushata “Ngrihuni për Ukrainën” ka mbledhur 9.1 miliardë euro për njerëzit që ikin nga bombat, brenda dhe jashtë Ukrainës, me një miliard euro shtesë të premtuar nga BERZH. Dhe më shumë do të vijë. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje. Dhe sapo bombat të kenë pushuar së rëni, ne do të ndihmojmë popullin e Ukrainës të rindërtojnë vendin e tyre. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë për Ukrainën”.



Fushata globale për mbledhjen e fondeve “Stand Up For Ukraine”

“Stand Up For Ukraine” ka mbledhur 9.1 miliardë euro për njerëzit që ikin nga pushtimi rus, brenda dhe jashtë Ukrainës

Kjo fushatë ka gjetur një përkrahje masive nga njerëz të thjeshtë e të famshëm në katër anët e globit

Ngjarja dhe fushata prem-tuese globale “Stand Up For Ukraine” (Ngrihuni për Ukrainën) ka mbledhur 9.1 miliardë euro për njerëzit që ikin nga pushtimi rus, brenda dhe jashtë Ukrainës, duke përfshirë 1 miliard euro nga Komisioni Europian. Për më tepër, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka shpallur një hua shtesë prej 1 miliard eurosh për të mbuluar nevojat e njerëzve të zhvendosur nga pushtimi.

Në njohje të rolit thelbësor të Polonisë në mbështetjen e refugjatëve që ikin nga pushtimi i Ukrainës, ngjarja prem-tuese “Stand Up For Ukraine”, e thirrur nga Presidentja e Komisionit Europian Ursula von der Leyen dhe kryeministri i Kanadasë Justin Trudeau u zhvillua në Varshavë, më 9 prill.

6.5 milionë qytetarë janë të zhvendosur brenda vendit. Përveç kësaj, Bashkimi Evropian po pret më shumë se 3.8 milionë refugjatë. Polonia po pret më shumë se 2.5 milionë refugjatë dhe luan një rol të rëndësishëm si një qendër humanitare, duke dërguar në Ukrainë mbështetje nga e gjithë Europa.

“Solidariteti i vendeve, kompanive dhe njerëzve në mbarë botën ofron pak dritë në këtë orë të errët. Fushata “Ngrihuni për Ukrainën” ka mbledhur 9.1 miliardë euro për njerëzit që ikin nga bombat, brenda dhe jashtë Ukrainës, me një miliard euro shtesë të premtuar nga BERZH. Dhe më shumë do të vijë. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje. Dhe sapo bombat të kenë pushuar së rëni, ne do të ndihmojmë popullin e Ukrainës të rindërtojnë vendin e tyre. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë për Ukrainën”, -tha në deklaraten e saj Ursula von der Leyen, Presidente e Komisionit Europian

“Sot, ne mblodhëm mbi 12.4 miliardë dollarë për të vazhduar mbështetjen e popullit ukrainas që është zhvendosur nga lufta e vazhdueshme dhe e pajustifikueshme e Putinit. Qoftë ushqim, ujë, strehim apo ndihmë mjekësore – ne do të vazhdojmë t’ju mbështesim dhe të ofrojmë ndihmën që ju nevojitet në këtë moment. Ne jemi në mbrojtje të Ukrainës”, -u shpreh Justin Trudeau, kryeministri i Kanadasë.

Nisma prem-tuese në internet “Stand Up For Ukraine” përfundoi në një fushatë më të gjerë në mediat sociale të nisur nga Komisioni Europian dhe Qeveria në Kanada më 26 mars, në partneritet me organizatën ndërkombëtare të avokimit “Global Citizen”.

Fushata iu përgjigj thirrjes për mbështetje të nisur nga Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy.

Qëllimi i fushatës ishte të mblidhte fonde dhe lloje të tjera mbështetjeje për të përmbushur nevojat e personave të zhvendosur brenda vendit në Ukrainë dhe të refugjatëve të zhvendosur në



vendet e BE-së. Veçanërisht:

- Për më shumë se 4 milionë njerëz që kanë kërkuar tashmë strehim në BE dhe për të tjerët që ka të ngjarë të vijnë; financimi do të përdoret për të përmbushur nevojat e tyre afatshkurtra dhe afatmesme në Shtetet Anëtare të BE-së, nga ushqimi, strehimi dhe mjekësia, kujdesin për arsimin dhe punësimin.

- Për 6.5 milionë njerëz, duke përfshirë 2.5 milionë fëmijë, të cilëve iu desh të largoheshin nga shtëpitë e tyre, por edhe ata që qëndruan në Ukrainë dhe tani janë të zhvendosur brenda vendit, financimi

dhe donacionet do t’u ofrojnë atyre kujdes jetik humanitar.

“Stand Up For Ukraine” synon të mobilizojë qeveritë, institucionet, artistët, kompanitë dhe individët për të mbledhur fonde dhe lloje të tjera mbështetjeje për të përmbushur nevojat e njerëzve të zhvendosur brenda vendit në Ukrainë dhe të refugjatëve. Artistë nga e gjithë bota i janë bashkuar tashmë fushatës - duke përfshirë Bono, Madonna, Elton John, Miley Cyrus, Adam Lambert, Céline Dion ose Alanis Morissette, Ellen Degeneres për të përmendur vetëm disa - dhe më shumë do t’i bashkohen.



Vendet e BE-së do të marrin 3.5 miliardë euro para-financim shtesë për pritjen e refugjatëve nga Ukraina

Për të lehtësuar pritjen e refugjatëve që ikin nga Ukraina për shkak të agresionit rus, Këshilli Europian miratoi një akt legjislativ duke vënë në dispozicion 3.5 miliardë euro shtesë në total këtë vit, të cilat shtetet anëtare do t’i marrin në bazë të numrit të refugjatëve që vijnë nga Ukraina. Akti prezanton ndryshime për të rritur para-financimin nën Ndhimën e Rimëkëmbjes për Kohezionin dhe Territorët e Europës (REACT-EU), një nga programet më të mëdha të rimëkëmbjes pas pandemisë, për të përforcuar fondet e politikës së kohezionit dhe Fondi për Ndhimën Europiane për Më të Paprivuarit (FEAD). Konkretisht, para-financimi që do të paguhet nga REACT-EU në 2022 do të rritet nga 11% në 15% për të gjitha shtetet anëtare dhe nga 11% në 45% për vendet e BE-së, ku numri i të ardhurve nga Ukraina ishte më i madh se 1% e popullsisë e tyre në fund të muajit të parë pas pushtimit rus. Për të thjeshtuar mobilizimin e fondeve, akti prezanton gjithashtu mundësinë e një kostoje për njësi për person, duke bërë të mundur plotësimin më efektiv të nevojave bazë të personave të zhvendosur nga Ukraina dhe t’u ofrohet atyre asistencë bazë. Këto ndryshime synojnë të zbusin presionin mbi buxhetet publike të shteteve anëtare, në mënyrë që ata të përballen më mirë me fluksin e refugjatëve.



Agresioni rus në Ukrainë: Deputetët e Parlamentit Europian vlerësojnë solidaritetin e jashtëzakonshëm me refugjatët



Deri më 8 mars, më shumë se 2 milionë refugjatë, kryesisht gra dhe fëmijë, janë larguar nga Ukraina

Ndërsa më shumë se dy milionë refugjatë ikin nga lufta në Ukrainë, kryesisht drejt BE-së, shtetet anëtare do të duhet të vazhdojnë të tregojnë

solidaritë, thanë eurodeputetët të martën. Në një debat plenar me Brigitte Klinkert, Ministre e deleguar për Përfshirjen Ekonomike, në emër të Këshillit, dhe komisioneren Ylva Johansson, eurodeputetët theksuan situatën dramatike humanitare dhe refugjatëve të shkakuar nga sulmi rus në Ukrainë. Ata vlerësuan shtetet e vijës së parë për angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm deri më tani, por paralajmëruan se solidariteti i qëndrueshëm në të gjithë BE-në do të jetë i nevojshëm në planin afatgjatë. Folësit dënuan njëzëri agresionin e Rusisë kundër Ukrainës. Komisionerja Ylva Johansson theksoi presionin e jashtëzakonshëm ndaj vendeve anëtare që ndajnë kufijtë me Ukrainën: Poloninë, Hungarinë, Sllovakinë dhe Rumaninë, si dhe Republikën e Moldavisë. BE-ja u përball me sfidën kur Këshilli aktivizoi njëzëri mekanizmin e mbrojtjes së përkohshme, duke ofruar solidaritet në të gjithë BE-në, duke mbështetur agjencinë e OKB-së për refugjatët (UNHCR) dhe Kryqin e Kuq që punonin në terren, dhe nëpërmjet aktivizimit të 500 milionë eurove në ndihmë humanitare.

Eurodeputetët mirëpritën gjithashtu reagimin e shpejtë të BE-së, duke siguruar mbrojtje për ata që ikin nga Ukraina dhe kërkuar ndihmë të mjaftueshme financiare për të ruajtur mbështetjen në afat të mesëm dhe afatgjatë. Disa folës dëshiruan të shihnin përparim konkret në reformën e rregullave të BE-së për migracionin dhe azilin, ndërsa të tjerë theksuan se të gjithë refugjatët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, kanë nevojë për të njëjtën mbrojtje.



Mbrojtje e përkohshme për njerëzit që ikin nga Ukraina

Në një rezolutë të miratuar gjatë një seance plenare të jashtëzakonshme, Parlamenti përshëndeti aktivizimin e Direktivës së Mbrojtjes së Përkohshme për herë të parë që kur ajo hyri në fuqi në 2001. Direktiva synon t’u japë mbrojtje të përkohshme të menjëhershme në BE, njerëzve që ikin nga lufta në Ukrainë, duke përfshirë shtetas ukrainas, njerëz jashtë BE-së, persona pa shtetësi ose persona me leje qëndrimi në vend.

Kjo u lejon personave të zhvendosur të përfitojnë nga të njëjtat të drejta në të gjithë BE-në, si leja e qëndrimit, mundësia për të punuar, strehimi dhe aksesin në mirëqenien sociale dhe ndihmën mjekësore. Mbrojtja e përkohshme nuk i pengon të interesuarit të aplikojnë për azil.

Më 9 mars, eurodeputetët i bënë thirrje BE-së të prezantojë një sistem të duhur migracioni që ndan përgjegjësinë për refugjatët.

Pakti i BE-së për migracionin dhe azilin, i cili po negociohet, përfshin një mekanizëm solidariteti që shpërndan përgjegjësinë për mbrojtjen midis vendeve të BE-së dhe masat që adresojnë flukset masive të emigrantëve.

Reagimi i BE-së ndaj krizës së refugjatëve në Ukrainë



Pushtimi rus i Ukrainës ka detyruar miliona njerëz të lënë shtëpitë e tyre

Pushtimi rus i Ukrainës, në shkurt 2022, ka krijuar një nga krizat më të mëdha humanitare në historinë e fundit të Europës, me luftën e vazhdueshme që ka shkaktuar një numër në rritje të viktimave, shkatërrime dhe zhvendosje brenda dhe jashtë kufijve të Ukrainës. Popullsia civile e Ukrainës po i nënshtrohet bombardimeve dhe dhunës, me miliona njerëz që janë zhvendosur, qoftë brenda vendit ose në shtetet fqinje, kryesisht në Poloni, por edhe në Rumani, Sllovaki, Hungari dhe Moldavi. Rreth 90% e tyre janë gra dhe fëmijë, të cilët janë gjithashtu në rrezik më të lartë të dhunës dhe abuzimit, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën dhe birësimin e paligjshëm.

Reagimi i BE-së ndaj krizës së refugjatëve në Ukrainë

Fondet e BE-së për të mbështetur vendet e vijës së parë Kriza e refugjatëve e shkaktuar nga lufta ka nxitur valë solidariteti dhe mobilizimi në të gjithë Europën, me BE-në dhe shtetet e saj anëtare që ofrojnë ndihmë urgjente për të zhvendosurit dhe mbështetje për vendet në kufi me Ukrainën. Më 24 mars, eurodeputetët miratuan propozimin e Komisionit European për Veprimin e Kohezionit për Refugjatët në Europë për të ridrejtuar fondet e disponueshme në vendet e BE-së që strehojnë njerëzit që ikin nga agresioni rus. Kjo mund të përfshijë një shtesë prej 10 miliardë eurosh nga “React-EU”, një fond i krijuar për të vepruar si një urë lidhëse midis masave të urgjencës Covid dhe fondeve të kohezionit. Parlamenti gjithashtu zgjati për një vit - deri në mesin e vitit 2024 - periudhën në të cilën funksionojnë Fondi për Azilin, Migracionin dhe Integrimin dhe Fondi i Sigurisë së Brendshme. Zgjerimi u lejon vendeve të BE-së të rishpërndajnë urgjentisht fondet e papërdorura për t’u marrë me fluksin e refugjatëve nga Ukraina dhe pritët të lirojë rreth 420 milionë euro për mbështetje shtesë, si strehimi, ushqimi, kujdesi shëndetësor ose staf shtesë. Ndihma të mëtejshme, si furnizime mjekësore, tenda dhe gjeneratorë të energjisë, janë kanalizuar në vendet fqinje me Ukrainën nëpërmjet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së dhe rezervave mjekësore “RescEU”. Gjatë seancës plenare të 23-24 marsit, eurodeputetët ranë dakord gjithashtu t’i ofrojnë Moldavisë mbështetje financiare për të ndihmuar në pritjen e refugjatëve, përveç dhënies së ndihmës makro-financiare për të mbuluar një pjesë të nevojave të saj për financim të jashtëm.

Menaxhimi i kufijve të jashtëm të BE-së

Komisioni European nxori udhëzime të reja për të ndihmuar vendet e BE-së të menaxhojnë mbërritjet në mënyrë efikase dhe të ndihmojnë rojet kufitare që kryejnë kontrolle në kufijtë me Ukrainën, duke përfshirë thjeshtimin e kontrolleve kufitare për personat e cënueshëm dhe krijimin e pikave të kalimit të përkohshëm kufitar. Parlamenti miratoi gjithashtu vendosjen e Agjencisë Europiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) për të ndihmuar Moldavinë, e cila nuk është anëtare e BE-së, të menaxhojë numrin masiv të njerëzve që kalojnë kufirin nga Ukraina.

Ndihma humanitare

Presidentja e Komisionit, Ursula von der Leyen, njoftoi një paketë emergjente prej afro 550 milionë euro për t’u marrë me pasojat humanitare të krizës. Si pjesë e kësaj, 93 milionë euro janë vënë në dispozicion për programet e ndihmës humanitare për të ndihmuar civilët e prekur nga lufta në Ukrainë. Kjo përfshin 85 milionë euro për Ukrainën dhe 8 milionë euro për Moldavinë përkatësisht, për të ofruar ndihmë për njerëzit që ikin nga Ukraina. Kjo ndihmë humanitare e BE-së ofron ushqim, ujë, kujdes shëndetësor, strehim dhe ndihmon në mbulimin e nevojave themelore të njerëzve. Nga këto 550 milionë euro, 330 milionë euro shkojnë për një program mbështetës emergjent që ndihmon për të siguruar akses në mallrat dhe shërbimet bazë, si arsimi, kujdesi shëndetësor dhe ushqimi. Ai gjithashtu ndihmon për të mbrojtur popullsinë, si për personat e zhvendosur brenda vendit, ashtu edhe për komunitetet e tyre pritëse dhe për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bujqësinë. Një qëllim tjetër i rëndësishëm është rindërtimi i infrastrukturës civile në shkallë të vogël, garantimi i sigurisë energjetike dhe forcimi i sigurisë kibernetike, liria e medias dhe veprimet kundër dezinformimit.

Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së



29 vende kanë ofruar ndihmën e tyre 13 000 ton ndihma janë dërguar në Ukrainë

Nëpërmjet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së, po kanalizohet ndihma për Ukrainën nga 29 vende - 27 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Turqia. Kjo përfshin artikuj të tillë si kutitë e ndihmës së parë, veshjet mbrojtëse, dezinfektuesit si dhe tendat, pajisjet e zjarrfikësve, gjeneratorët e energjisë dhe pompat e ujit. Moldavia aktivizoi gjithashtu Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së për të mbështetur ukrainasit që mbërrijnë në vendin e tyre. 17 Shtete Anëtare të BE-së, plus Norvegjia, kanë ofruar ndihmë të ndryshme për Moldavinë, duke përfshirë strehimore, komplete higjienike dhe gjeneratorë të energjisë. Komisioni ka koordinuar gjithashtu ndihmën e mbrojtjes civile për Poloninë, Sllovakinë dhe Çekinë për të ndihmuar refugjatët ukrainas. Polonia ka marrë mbështetje nga Franca, Danimarka, Gjermania, Austria dhe Belgjika nëpërmjet Mekanizmit, duke marrë pajisje strehimi dhe furnizime mjekësore.

Josep Borrell: 500 milionë euro shtesë për të mbështetur furnizimet e Shteteve Anëtare të BE-së me pajisje ushtarake për Forcat e Armatosura të Ukrainës



Këshilli miratoi dy masa ndihme në kuadër të Facilitetit Evropian të Paqes (EPF) që do t’i lejojnë BE-së të mbështesë më tej aftësitë dhe qëndrueshmërinë e Forcave të Armatosura të Ukrainës për të mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit, si dhe për të mbrojtur popullsinë civile

kundër agresionit ushtarak rus që po vazhdon. BE-ja do t’i shtojë 500 milionë euro burimeve të mobilizuara tashmë nën EPF për Ukrainën, duke trefishuar kështu buxhetin fillestar në 1.5 miliardë euro. “Me këto 500 milionë euro shtesë, BE-ja ka ndarë një total prej 1.5 miliardë eurosh për të mbështetur furnizimet e Shteteve Anëtare të BE-së me pajisje ushtarake për Forcat e Armatosura të Ukrainës. Javët e ardhshme do të jenë vendimtare. Ndërsa Rusia përgatitet për një ofensivë në lindje të Ukrainës, është thelbësore që ne të vazhdojmë dhe të shtojmë mbështetjen tonë ushtarake për Ukrainën për të mbrojtur territorin dhe popullsinë e saj dhe për të parandaluar vuajtjet e mëtejshme”, -Josep Borrell, Përfaqësues i Lartë për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë. Kohëzgjatja e masave të ndihmës zgjatet edhe me 24 muaj.

Ukraina: BE-ja duhet të mbrojë të gjithë fëmijët që ikin nga lufta



2 milionë refugjatë që ikin nga Ukraina janë fëmijë, 2,5 milionë fëmijë janë zhvendosur brenda vendit

- Korridoret humanitare të nevojshme për të shpëtuar fëmijët dhe familjet në Ukrainë.
- Regjistrimi është çelësi për të parandaluar rrezikun e trafikimit dhe birësimeve të paligjshme.
- Fëmijët e cënueshëm duhet të identifikohen në kufijtë e BE-së dhe kujdestarët duhet të caktohen shpejt për fëmijët e pashoqëruar.
- Ata duhet të kenë të njëjtën akses në arsim dhe shërbime shëndetësore si fëmijët e tjerë në vendet pritëse.

Eurodeputetët bëjnë thirrje që fëmijëve që ikin nga lufta në Ukrainë t’u jepet një kalim i sigurt dhe ndihmë për të zhvendosurit brenda vendit ose ata që nuk janë në gjendje të largohen nga zonat e rrethuara. Me 509 vota pro, 3 kundër dhe 47 abstenime, Parlamenti European miratoi një rezolutë që kujton masat e ndryshme të nevojshme për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë që ikin nga dhuna dhe për të lehtësuar integrimin e tyre në komunitetet e vendit pritës. “Çdo fëmijë ka të drejtë të mbrohet nga dhuna, shfrytëzimi dhe abuzimi”, -thonë eurodeputetët, duke u bërë thirrje vendeve të BE-së që të mbrojnë fëmijët nga rreziku i trafikimit, birësimit të paligjshëm dhe llojeve të tjera të abuzimit. Ata rekomandojnë që oficerët e mbrojtjes së fëmijëve të jenë të pranishëm në kufij, për të qenë në gjendje të identifikojnë me shpejtësi dhe saktësi fëmijët e

cënueshëm, të regjistrojnë identitetin dhe kombësinë e tyre si dhe nevojat e tyre specifike. Shërbime të tilla si mbështetja psiko-sociale, mbështetja e shëndetit të nënës, mbrojtja kundër dhunës me bazë gjinore, gjurmimi i familjes dhe mbështetja për bashkimin e familjes duhet të ofrohen brenda sistemeve kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve, së bashku me akses të plotë në të gjitha shërbimet bazë dhe kujdesin e duhur.

Fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë dhe fëmijët në përkujdesje institucionale duhet të kenë të caktuar një kujdestar. Shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve në vendin e pritjes duhet t’i monitorojnë vazhdimisht ata për mirëqenien dhe vendndodhjen e tyre pas mbërritjes së tyre në BE, thuhet në rezolutë. Vendet pritëse duhet të sigurojnë që ata të kenë të njëjtin akses në arsim dhe shërbime shëndetësore si fëmijët e tjerë në vendet pritëse, këmbëngulin eurodeputetët. Ata gjithashtu evokojnë për mekanizmat e zhvendosjes që kanë prioritet bashkimin e familjes dhe zhvendosjen e fëmijëve në nevojë, si për shembull mekanizmi i solidaritetit për transferimet mjekësore brenda BE-së, të fëmijëve dhe të rinjve që kanë nevojë për trajtim dhe terapi të menjëhershme për shpëtimin e jetës. Eurodeputetët u bëjnë thirrje vendeve të BE-së që të përdorin sa më mirë fondet e BE-së në dispozicion për të mbështetur integrimin socio-ekonomik të refugjatëve dhe për t’i mbrojtur ata nga diskriminimi dhe përjashtimi social. Nëse është e nevojshme, duhet të sigurohen burime shtesë. Pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia, më shumë se katër milionë njerëz janë detyruar të lënë shtëpitë e tyre dhe të kërkojnë strehim, kryesisht në vendet fqinje të BE-së, përkatësisht Poloni, Rumani, Hungari, Sllovaki dhe Çeki, si dhe në Republikën e Moldavisë. Pothuajse gjysma e atyre që ikin janë të mitur, sipas UNICEF-it, dhe kanë nevojë për mbrojtje të shtuar, pasi rrezikojnë më shumë të bien viktimë e trafikimit dhe shfrytëzimit.

NGA KOLANA “OFICERET SHQIPTARE, NË RRJEDHËN E HISTORISË”

Gratë tribune shqiptare që lanë gjurmë në histori

Nora e Kelmendit, komandantja trimëreshë

Nora lindi në fillim të shek. XVII në Tamarë të Kelmendit. Një ditë në shtëpinë e saj burrat u mblodhën në kuvend. Ajo dëgjoi se osmanlinjtë me forca të shumta ishin nisur me urë në dorë për të djegur përsëri vatrat e kelmendasve, për të mposhtur shpirtin e tyre liridashës, burrat t'i kthenin në robër ndërsa gratë e bukura të Kelmendit t'i dërgonin në haremet e pashallarëve të Stambollit. Gjatë kësaj kohe në mbarë Kelmendin u dha kushtrimi. Kuvendet pasuan njëritjetrit. Për luftë kundër armikut u ngritën në këmbë burra dhe gra. Nora u vu në krye të grave e të vajzave malësore. Në kuvende ata u betuan të gjithë njëzëri mbi shpatat e tyre, se nuk do të lënë këmbë armiku të shkelë Kelmendin. Malësorët në fillim rrëzuan urat. Përpara epërsisë numerike të kundërshtarit në njerëz dhe në armatime, zgjodhën luftën e çetave, duke zbatuar taktikën luftarake popullore: “Tërhiqe armikun, përgatiti pusinë dhe sulmoje në befasi”. Shumë herë Nora së bashku me shoqet e saj, me lëvizjet e tyre të shpejta, i tërhiqnin armiqët në brendësi të vendit dhe atje ushtarët e Vuçe pashës përfundonin nën presën e jataganit të trimave të Kelmendit. Të shumtë ishin burrat dhe gratë e Kelmendit që dolën vullnetarë për vrasjen e Vuçe pashës, po Nora kërkoi me këmbëngulje që t'i besohej asaj kjo detyrë. Mbas shumë diskutimesh, kuvendi pranoi t'ia plotësojë këtë dëshirë Norës. Dhe rasti erdhi. Kuvendi i kelmendasve në përgjigje të kërkesës të Vuçe pashës, pranoi propozimin e turqve për të arritur në marrëveshje në qoftë se Vuçe pasha do të pranonte disa kushte. Si ndërmjetëse për bashkëbisedim kelmendasit dërguan në shtabin e komandës turke luftëtaren e tyre, Norën. Ata e porositën Norën të tregohej shumë e zgjuar, se kishte të bënte me një pasha dinak, aq shumë i përmendur për kurthe dhe intriga, që nuk di çfarë është besa, fjala e dhënë e shqiptarit. Këta trima i kujtuan Norës vrasjen e pabesë, mbas shpine të përfaqësuesve të Kelmendit para një viti nga Vuçe pasha, i cili jo vetëm nuk i qëndroi fjalës së dhënë për bashkëbisedim me këta malësorë por me të arritur këta trima në shtabin e tij, urdhëroi menjëherë masakrimin e tyre. Trimëresha e zgjuar Nora e shoqëruar dhe me dy nga trimat më të rinj të kësaj krahine, u nis kaluar drejt shtabit të armikut.

Vuçe pasha i priti në çadrën e tij. Ky komandant dinak i sulltanit, gjatë bisedës me këtë përfaqësuese të Kelmendit mbeti gojëhapur nga bukuria mahnitëse e Norës. Ai i pranoi të gjitha kushtet e kryengritësve, mjaftonte që kjo shqiponjë mali të bëhej gruaja e tij dhe u ngrit në këmbë e iu afrua Norës. Ajo me shpejtësi si rrufeja nxori kurqelin (një lloj thike që e mbajnë vajzat për të ruajtur nderin) dhe ia nguli përnjëherësh në zemër pashait të madh osmanli, duke i drejtuar këto fjalë: “Po të martoj, o pashë më parë me vdekjen” dhe së bashku me shoqëruarit e saj u largua drejt maleve, duke lënë të shtrirë të mbytur në gjak këtë tiran dinak.

Beteja e Kelmendit kundër osmanlinjve gjatë vitit 1638 përfundoi me fitoren e shqiptarëve. Një pjesë e mirë e kësaj fitoreje erdhi edhe nga lufta e denjë e grave dhe e vajzave të Kelmendit me në krye sokoleshën Nora.

“Heroina e Popullit”, komandantja trime Sado Koshena nga Dukati i Vlorës

Sado Koshena lindi në fshatin Dukat të Vlorës, më 20 gusht të vitit 1855 dhe iku nga kjo jetë më 14 prill të vitit 1955. Ajo ka qenë luftëtare shqiptare, tribunë popullore për atdhetari dhe pjesëmarrëse në Luftën e Vlorës me armë në dorë si dhe kundër shovinistëve jugorë grekë, që synonin pushtimin dhe aneksimin e Shqipërisë. Gjatë rezistencës shqiptare kundër pushtimit të vendit, që nga prilli i vitit 1939 deri në çlirim e plotë të vendit, ajo përkrahu fuqimisht Frontin Antifashist Nacional-Çlirimtar.

Sado Hamzo Koshena lindi në Dukat të Vlorës, ku edhe kaloi tërë jetën e saj. Aty jetoi dhe u nda me nder nga jeta në kohën kur po mbushte një shekull jetë. Atdhetare, pjesëmarrëse me armë në dorë në luftë për çlirim e vendit dhe mbrojtjen e tij nga shovinistët grekë dhe pushtuesit italianë. Thuhet se më 1907, së bashku me burrat ka qëndruar kundër xhandarëve turq. Me thirrjen e Qeverisë së Vlorës



në dhjetor 1912, Sado Koshena së bashku me të dy djemtë e saj luftoi në Llogora kundër forcave greke që kishin zbarkuar në Himarë dhe që me ndihmën e disa tradhtarëve vendas synonin zgjerimin e zonës së pushtimit dhe rrëzimin e Qeverisë së Vlorës. Në verën e vitit 1920, ashtu si Rubi Hosi, gruaja e dëshmorit Toto Hosi dhe Hako Mete nga Bolena edhe Sado Koshena u radhit vullnetarisht përkrah burrave të fshatit dhe djemve të saj në luftë për çlirim e vendit nga pushtuesi Italian. U dallua në guximin, trimërinë në përpjekjen e Qafës së Përrallit, afër Dukatit dhe në luftime të tjera duke u dhënë zëmër luftëtarëve të lirisë. Sado Koshena ndërroi jetë në moshën gati 100-vjeçare, më 1955. Iu dha titulli “Heroinë e Popullit”, më 1970 dhe iu vendos busti në fshat.

Emri i një zonje të nderuar, Sado Koshena, është gdhendur në epikën historike. Shumë këngë janë kënduar dhe këndohen për këtë heroinë, janë ngritur memorialë, emrin e saj e kanë marrë objekte, rrugë dhe institucione. Për të janë shkruar dhe libra. Në librin “Gra të njohura të trojeve shqiptare”, shkruar nga Hanëm shahe Ilazi, ndër të tjera, për Sado Koshenën shkruhet: “...Sado u bëri qëndresë heroike xhandarëve turq, të cilët e torturuan për kunatin, që nuk pranoi të shërbente në ushtrinë turke. Atëherë ishte 52 vjeç. Me thirrjen e Qeverisë së Ismail Qemalit, më 27 dhjetor 1912, me të dy djemtë e saj dhe me gjerdanin me fishekë dhe mauzerin në dorë, luftoi në Llogora kundër forcave greke, që kishin zbritur në Himarë. Në moshën 65 vjeçe, me tre djemtë e saj dhe çetën prej 13 vetash, që e drejtonte vetë, më 4-5 qershor 1920 shpartallojnë garnizonin italian. Ditën luftonte e natën barte municion e armë për çetën. Më 12 qershor, në luftën për çlirim e Vlorës, Sado nisët në Drashovicë. Lufta më e përgjakshme ka qenë në Shushicë më 18-19 korrik 1920, kundër hordhve italiane, e sidomos dallohet në luftën e Qafës së Përrallit, afër Dukatit. Në LANÇ ishte 90 vjeçe dhe duke e përkrahur atë me gjithë djemtë e saj. Në moshën 100 vjeçare, më 1955, vdes.” Ndërsa brezi i ri, tek akti i kësaj prijëse luftëtare, shikon dhe shembullin më kuptimplotë të atdhedashurisë. Ja si thuhet në një këngë kushtuar heroinës Sado Koshena, përmbledhur nga shkrimtari e historiani Albert Habazaj: “Sado, Sado Koshena jeshë rritur në Ravena, / Keshje pirë ujë bore, / N’ato kullota verore, / Mbi polkë veshe gjerdanë, / More perpjete Llogarasë, / Me një maliher të gjatë, / Luftove me ditë e natë, / Ti vëlla keshje dyfekun, / Me plumba e prite grekun, / Hape zjarr mbi italianë, se të zaptuan vatanë.”

Bule Naipi, “Heroina e Popullit” që u var në litar në mes të Gjirokastrës, nga gjermano-ballistët

Bule Naipi, “Heroinë e Popullit”, lindi në vitin 1920 në lagjen Dunavat të qytetit Gjirokastër. Shtëpia e saj ishte bazë e rëndësishme e LANÇ-it. Vetë Bulja ishte anëtare e Komitetit Qarkor. Veprimtaria e saj ishte në qytet dhe në krahinat fshatare. U njoh si partizane në male dhe si ilegale në qytet. Ajo gjendej kudo, në qytet dhe fshat. Veprimtaria e Bule Naipit shfaqej në marrjen pjesë të grave e vajzave në demonstrata e luftë. Bule Naipi endej shtigjeve të Malit të Gjerë, maleve të krahinës së Kardhiqit. Për herë në veprime luftarake. Kudo ku shkonte nëpër fshatra zëri i saj bindës i tërhiqte me vete edhe vajzat në kompanitë partizane, me dëshirën e tyre për ta çliruar Shqipërinë e robëruar nga të huajt. Radhët e brigadës mbusheshin me vajza partizane nga



Prongjia, Fushëbardha, Lunxhëria, Kurveleshi. Ecte nëpër shtigjet partizane, duke kënduar me zë të lartë këngën himn të Memo Metos: “Dua armë e municion se do shkoj/E urrej dhe unë fashizmin do luftoj/Jam një vajzë shqiptare, vajzë mali/ E kam forcën, e kam zemrën si të djalit...”. Shfaqej Bulja partizane në Cepo mes luftëtarëve të lirisë, ku errej, nuk gdhijej. Në korrik u burgos dhe iu nënshtrua torturave më të rënda. Më 17 korrik 1944 armiqët nazistë e varën në litar te sheshi i Çerçizit në Gjirokastër.


Ish-partizani dhe Historiani Dalan Buxheli, referuar dokumenteve të kohës, jep detare të tjera për heroinën dhe shoqen e saj që u varën në litar. Ja si shkruan ai: “... Në ato vite të robërimit të Shqipërisë, kur atdheun e kishte mbuluar kudo mjerimi, kur në zemrat e shqiptarëve e të rinisë vlonte revolta dhe urrejtja ndaj pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tyre, ishte rritur e forcuar besimi për fitoren e afërt, heroinat Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima punuan e luftuan pa u lodhur për të sabotuar planet luftarake të fashistëve italianë dhe më vonë të nazistëve gjermanë. Ato me motivin VFLP u bënë tmerr për armikun. Është rast unikal në historinë e Shqipërisë pjesëmarrja në formacionet partizane e 6000 vajza e grave me armë në dorë për çlirim e Shqipërisë, ku 24 prej tyre janë shpallur “Heroina të Popullit”. Në këtë armatë të madhe me vajza e gra, të cilat u bënë agjitatore dhe luftëtare të zjarra, bëjnë pjesë dhe Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima që, kur u kapën nga armiku, pranuan vdekjen dhe shokët nuk i tradhtuan. Ato u varën në litar në sheshin “Çerçiz Topulli”, më 17 korrik 1944 prej dorës gjakatare të Gestapos gjermane e ballistëve të përfaqësuar nga kriminelit Idri Jazo, Komandant i Xhandarmërisë së Gjirokastrës, Veip Runa prefekt i Gjirokastrës, Ahmet Nivica e Xhafer Leskoviku që spiunuan kapjen dhe ekzekutimin e tyre. Ishin dy vajza të reja nga mosha por vigane nga shpirti e qëndresa... Tradhtia e ballistëve të drejtuar nga sekretari i qarkorit ballist të Gjirokastrës, Ismail Golemi qëndron në veprimtarinë e hershme e të turpshme ku sipas të dhënave arkivore rezultojnë se në trupin gjykues të përbërë prej 6 vetash, vetëm njëri ishte gjerman, 5 të tjerë ishin ballistë kolaboracionistë shqiptarë që dhanë dënimin me varje në litar për Persefonin e Bulen.

Naxhije Dume, drejtuese në prapavijë e formacionet partizane dhe gruaja e parë ministre në Shqipëri

Naxhije Dume ka lindur në Lubonjë të Kolonjës, më 3 janar 1921 dhe ka ndërruar jetë në Tiranë, në vitin 1996. Ajo ishte veprimtare e Frontit Nacional-Çlirimtar gjatë rezistencës shqiptare, partizane dhe drejtuese formacionesh luftarake në luftë, anëtare e Komitetit Qendror dhe ministrja e parë femër në Shqipëri. Naxhija vinte nga një familje intelektuale (i ati i saj nëpunës i njohur) dhe për këtë shkak, shkollimi i saj fillestar ishte i ndërvarur me vend-punësimet e të atit.

Për këtë, asaj iu desh të shkollohej në Ersekë, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Korçë. Ndoqi mësimet në vitet 1933-1941 në Institutin Femëror “Nana Mbretëreshë”, të cilat i përfundoi me rezultate shumë të mira. Pasi kreu mësimet, e emëruan mësuese në shkollën “Avni Rustemi”, në Tiranë. Naxhija mori pjesë në të gjitha demonstratat dhe aktivitetet antifashiste të ditëve të para të prillit 1939. Në vitin 1943, Naxhija ishte sekretare e komitetit të gruas komuniste të Korçës, ndërsa në Konferencën e Parë të Vendi, kur ishte vetëm 23-vjeçare, ajo do të ishte një nga anëtarët e Komitetit Qendror definitiv të PKSH-së. Gjatë kësaj periudhe por dhe gjatë Luftës Antifashiste, ajo ishte në drejtëm dhe përballje direkt me formacionet pushtuese, ku u evidentua si komandante me aftësi, që udhëhiqte me shembullin personal. Një vit më vonë e zgjodhën delegate të Qarkut të Korçës për në Kongresin e Përmetit, nga ku vjen anëtare e Këshillit Antifashist. Së bashku me Kristo Themelkon, caktohen për organizimin dhe përirimin e Brigadës XXII Sulmuese. Naxhija ishte një nga gratë që mori pjesë në mbledhjen e dytë të Komitetit Antifashist dhe punimet e plenumit të dytë të KQ të PKSH-së, që u mbajtën në Berat. Me transferimin e Qeverisë së re në Tiranë, emërohet pranë aparatit të Komitetit Qendror. Atje punoi deri në vitin 1948, vit në të cilin do të ngjitej në postin e Ministres së Arsimit. Deri atëherë, ajo ishte e vetmja grua shqiptare e të gjitha kohëve, që ishte emëruar si anëtare e ekzekutivit. Në Kongresin e Parë të PKSH-së, pas kritikash të ashpra dhe akuzash të Enver Hoxhës e Mehmet Shehut, Naxhije Dume u shkarkua nga të gjitha detyrat e larta shtetërore dhe partiake. Këtu fillon persekutimi i saj. Më pas, ajo caktohet drejtoreshë e Muzeumit Arkeologjik-Etnografik (1951) dhe drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare (1956). Më pas punoi drejtore e “Shkollës së Kuqe” dhe tek shkolla “Emin Duraku”. Më pas u transferua në Elbasan ku punoi drejtore e bibliotekës së qytetit. Pas Konferencës së Partisë së Tiranës filloi kalvari i ri edhe më i egër politik dhe administrativ për Naxhije Dumen dhe bashkëshortin e saj Nesti Kerenxhi. Pasi kishte punuar gjatë si arsimtare, në vitin 1972 doli në pension. Dhjetë vjet më vonë atë dhe familjen e saj e priste një fatkeqësi edhe më e rëndë, pasi i internuan përsëri në Petë-Mavrovë e Selenicë, të Vlorës. Vetëm në vitin 1996 familja kthehet përsëri në Tiranë.





Prokuroria e Posaçme e Kosovës (PSRK) kishte nën hetim zyrtar 12 raste të krimeve të luftës. Gjatë vitit PSRK-ja ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve. Një rast i profilit të lartë të krimeve të luftës, i njohur si “Drenica I”, u dërgua për rigjykim në vitin 2017, por u vonua disa herë. Deri në dhjetor nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore.



DASH, për Kosovën

Në raportin për të drejtat e njeriut në botë në vitin 2021, Departamenti i Shtetit tha se në Kosovë çështjet e rëndësishme të këtyre të drejtave përfshinin raporte të besueshme për: kufizime serioze në lirinë e shprehjes dhe medias, duke përfshirë dhunën ose kërcënimet për dhunë ndaj gazetarëve; korrupsionin serioz qeveritar dhe mosndëshkimin dhe krimet që përfshijnë dhunën ose kërcënimet me dhunë ndaj pakicave etnike ose komuniteteve tjera të marginalizuara.

Qeveria, thuhet në raport, ndër-mori hapa për të identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zyrtarët që kryen shkelje të të drejtave të njeriut, por nganjëherë nuk kishte qëndrueshmëri në veprime.

Krimet e luftës

Në raport përmendet puna e Gjykatës së Posaçme të Kosovës për krime lufte, me seli në Hagë, dhe veprimet për ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës nga gjykatat në Kosovë.

Deri në shtator, Prokuroria e Posaçme e Kosovës (PSRK) kishte nën hetim zyrtar 12 raste të krimeve të luftës. Gjatë vitit PSRK-ja ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve. Një rast i profilit të lartë të krimeve të luftës, i njohur si “Drenica I”, u dërgua për rigjykim në vitin 2017, por u vonua disa herë. Deri në dhjetor nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore.

Raporti vë re se në korrik, një gjykatë në Prishtinë dënoi ish-policin serb, Zoran Vukotić me tre vjet e gjysmë heqje lirie për përdhunimin e një gruaje shqiptare shtatzënë gjatë kohës së luftës dhe për pjesëmarrje në dëbimet e civilëve shqiptarë të Kosovës nga qyteti i Vushtrrisë, në vitin 1999. Që nga viti 2019, Vukotići ishte në vuajtje të dënimit prej gjashtë vitesh e gjysmë për krimet e luftës të ndalimit dhe torturimit të paligjshëm të të burgosurve shqiptarë nga Kosova në rajonin e Mitrovicës. Dënimi shtesë shënoi herën e parë që një gjykatë e Kosovës dënon një të pandehur për përdhunim gjatë luftës.

“Kosovë: Dhjetë vjet heqje lirie për përdhunim gjatë luftës”

Raporti përfshin edhe dënimin, në muajin mars, të serbit nga Kosova Zlatan Krstić dhe shqiptarit Destan Shabani, të dy ish-oficerë të policisë serbe, me përkatësisht 14 vjet e gjysmë dhe shtatë vjet burgim, për krime lufte kundër civilëve shqiptarë në vitin 1999. Ndërsa në shkurt, një gjykatë në Prishtinë dënoi serbin e Kosovës, Zoran Gjokić me 12 vjet



heqje lirie për krime lufte kundër shqiptarëve të Kosovës të kryera ndërmjet marsit dhe prillit 1999 në rajonin e Pejës. Komisioni qeveritar për Persona të Zhdukur tha në muajin shtator se 1 mijë e 632 veta ende llogariten si të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998-99 dhe dhunës politike që pasoi. Sipas ligjit, baza e të dhënave të personave të zhdukur të qeverisë nuk përfshin përkatësinë etnike të personave të zhdukur, përveç nëse raportohet vullnetarisht nga familja e tyre. Komisioni la të kuptohet se rreth 70 për qind janë shqiptarë ndërsa 30 për qind ishin serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë, goranë, malazezë dhe të tjerë.

Keqtrajtimi i të burgosurve

Raporti përfshin edhe ankesat për keqtrajtimin e të burgosurve dhe përdorimin e dhunës nga pjesëtarët e organeve të rendit. Qeveria ndonjëherë hetonte shkeljet, megjithëse mekanizmat për ta bërë këtë nuk ishin gjithmonë efektivë ose ishin subjekt i ndërhyrjeve politike, gjatë periudhës që përfshin raportin. Forcat e sigurisë, thuhet më tej, nuk siguruan respektimin e urdhrave të gjykatës kur zyrtarët lokalë nuk i zbatuan ato. Edhe pse disa

oficerë policie u arrestuan me akuza për korrupsion gjatë vitit, mosndëshkimi mbeti një problem.

Raporti përfshin të dhënat e Inspektoratit Policor të Kosovës, i cili deri në nëntor kishte pranuar 1 862 ankesa, 617 prej të cilave janë dërguar për hetim penal. Ankesat ishin kryesisht për keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, keqpërdorim të detyrës zyrtare, lëndim trupor, kanosje dhe dhunë në familje. Inspektorati raportoi se 158 policë ishin nën hetim, 78 ishin pezulluar dhe 31 ishin arrestuar.

Pavarësia gjyqësore

Mes tjerash, raporti thekson se autoritetet ndonjëherë nuk arritën të zbatonin urdhrat e gjykatës, përfshirë edhe të Gjykatës Kushtetuese. Disa përfaqësues të serbëve të Kosovës pohuan se institucionet qeveritare dështuan në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në favor të serbëve të Kosovës, veçanërisht në mosmarrëveshjet lidhur me pronën. Autoritetet qendrore dhe lokale në Deçan vazhduan të refuzojnë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 që konfirmon pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe mbi më shumë se 24 hektarë tokë në afërsi të Man-

astirit të Deçanit. Në shtator, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje refuzimin e vazhdueshëm të qeverisë për të zbatuar vendimin e gjykatës dhe ia referoi çështjen prokurorit të shtetit. Deri në dhjetor, prokurori nuk kishte filluar procedimin penal. Asnjë nga zyrtarët që nuk kanë zbatuar urdhrin e gjykatës nuk janë sanksionuar, thuhet në raport.

Liria e shprehjes

Raporti thekson se ndonëse qeveria në përgjithësi e respektoi të drejtën e shprehjes, raportet e besueshme thonë se disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe fetare u përpoqën të frikësonin përfaqësuesit e medias. Problemet e financimit gjithashtu dëmtuan pavarësinë e medias. Gazetarët hasën në vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike, pavarësisht nga ligjet që ofrojnë qasje në dokumente publike.

Mediat e pavarura, thuhet më tej, ishin aktive dhe shprehën një shumëllojshmëri pikëpamjesh, përgjithësisht pa kufizime. Megjithatë, pati raporte se zyrtarë qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me qeverinë, grupe fetare dhe individë të pakënaqur u bënë trysni pronarëve të mediave,

redaktorëve dhe gazetarëve që të mos publikonin rrëfime ose materiale të caktuara. Disa gazetarë u përmbajtën nga raportimi kritik investigativ për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike ose vendin e punës. Deri në dhjetor, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës raportoi 26 raste kur zyrtarët qeveritarë, njerëz të biznesit apo përfaqësues të grupeve të komunitetit ose grupeve fetare, shkelën lirinë e shtypit duke sulmuar fizikisht ose kërcënuar verbalisht gazetarët.

“Kosovë: Sulmohet gazetari Visar Duriqi”

Raporti vë re se disa gazetarët u ankuan se pronarët dhe menaxherët e medias i penguan ata të botonin ose transmetonin materiale kritike ndaj qeverisë, partive politike ose zyrtarëve të veçantë.

Përdhunimet dhe Dhuna në familje

Raporti citon Misionin e Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit, sipas të cilit gjykatat shpesh zbatonin dënime më të lehta se minimumi ligjor në rastet e përdhunimit dhe se organet e sundimit të ligjit rrallë ndërmerrnin hapa për të mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët. Zyra e Prokurorisë për Ndhimë ndaj Viktimave, raportoi një rritje të dhunës familjare nga 1 mijë e 145 raste të raportuara në vitin 2020 në 1 mijë e 374 raste nga janarit deri në gusht të vitit 2021. Dhuna seksuale dhe përdhunimi që ndodhin brenda ose jashtë familjes, rrallë u raportuan nga viktimat, shpesh për shkak të frikës nga stigma shoqërore ose mungesa e besimit tek autoritetet.

“Protestë dhe reagime pas vrasjes së një 18-vjeçarjeje në qytetin e Ferizajt”

Raporti iu referohet organizatave për të drejtat e grave, sipas të cilave ngacmimi seksual ishte i zakonshëm në vendet e punës si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke përfshirë edhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Takimi

Presidentja Osmani: Lirinë e kemi fituar, por paqja për shumë qytetarë tanë nuk do të jetë e plotë derisa drejtësia për krimet e bëra të jetë përfundimtare”

14 prilli - Dita e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, mblodhi përfaqësues të lartë të shtetit kosovar, mes tyre e pranishme ishte edhe presidentja znj. Vjosa Osmani, e cila ishte dhe nismëtarja për të përcaktuar këtë ditë si simbol të dhimbjes dhe forcës së femrës kosovare në përballje me agresorin serb.

“Shënimi i 14 prillit, muajit kur ka pasur më së shumti dhunime gjatë luftës së fundit në Kosovë, do të ishte vulosje e përhershme e një kapitulli tragjik të historisë sonë, dhe do të ishte bashkim i zërave tanë, për të treguar se si gra e burra të Kosovës, përkundër vuajtjeve të mëdha, e shndërruan vuajtjen e tyre në forcë, për të ngritur zërin për drejtësi”, -tha Osmani.

Më tej presidentja foli edhe për situatën në Ukrainë, ku po raportohen përdhunime të grave nga ushtarët rusë.

“23 vite pas luftës në Kosovë, kur ne shpresonim se Europa e bota nuk

do zgjohej më me imazhe e me dhimbje në sy të vajzave dhe grave, por jo vetëm, dhimbja dhe trishtimi zuri vend sërish në kontinentin tonë. Sot disa prej jush, por edhe shumë gra të tjera në Kosovë, bashkëndejnë e kuptojnë më së miri dhimbjen, trishtimin e zhgënjimin që janë duke përjetuar vajzat dhe gratë në Ukrainë, por edhe në vende të tjera të botës”, -u shpreh e para e shtetit. “Ju vajza, gra, dhe burra, jeni shndërruar në rrëfyesin më të vërtetë e më të sinqertë, të vuajtjeve dhe përjetimeve të popullit tonë, e njëkohësisht jeni shndërruar në motivin tonë të përditshëm, në rrugëtimin tonë të përbashkët drejt drejtësisë. Drejtësia do të jetë e qëndrueshme vetëm atëherë kur kriminelët që kryen këto krime të dalin para drejtësisë. Lirinë e kemi fituar, por paqja për shumë qytetarë e qytetare tona nuk do të jetë e plotë përderisa drejtësia dhe ndëshkimi për krimet e bëra të jetë përfundimtare”.



NGA ZENO JAHAJ

Mistika e stërvitjes ushtarake me të cilën Kremli veshi rrethimin prej 5837 km të kufirit të Ukrainës, e invazionit ushtarak dhe e kërcënimit apokaliptik që i lëshoi botës në mëngjesin e 24 Shkurtit 2022, dalëngadalë po davaritet. Pasi aplikoi një shartim hibrid strategjik e taktikash, me pothuajse të gjitha llojet e armëve dhe angazhoi mbi 70 për qind të të gjitha forcave që ka në dispozicion, aktualisht makineria ruse po tërhiqet për t'u përqendruar në mbajtjen me çdo kusht në dy "republikave autonome" dhe, mundësisht, në tërë brezin që i lidh ato me Krimenë, ku përfshihet edhe Porti strategjik i Mariupolit.

Çka do të thotë se, makineria ruse e luftës jo vetëm ngeci, por edhe u tkurr, edhe pse sakrifikoji jetët e rreth dhjetë mijë ushtarëve e të jo pak gjeneralëve, shifra tronditëse, për vetëm dyzetë e dy ditë luftimesh! Nuk është çështja se ngecën qindra tanke e mijëra makina luftarake ruse nëpër rrugët e baltërat e Ukrainës. Ngeci makineria ideologjike ultranacionaliste dhe neonaziste ruse, sipas së cilës, ose do të bëhet një Rusi e madhe, ose përndryshe nuk do të ekzistojë fare Rusi, se Rusia është gjithçka dhe gjithçka tjetër është asgjë, se Rusia ka një kod gjenetik të pambarrim të bazuar në përzierjen e gjakut dhe se ajo, prandaj, është në marshim të përhershëm. Ngeci makineria politike ruse, sipas të cilës, ka ardhur koha që vendet dhe popujt duhen qeverisur me autokratë e autoritaristë, jo me demokraci e liberalizëm. Kremli nuk përllogarit se, në një botë gjithnjë e më shumë globaliste, të sulmshëm një vend demokratik, ke sulmuar të gjithë botën demokratike.

Nuk përllogarit dot se, në krah të popullit të Ukrainës, do të luftonte e gjithë bota demokratike, me çfarëdo mjeti të mundshëm. Rusia e mbyti informacionin nga, dhe për, gjendjen e vërtetë të zhvillimeve në Ukrainë. Përkundrazi, Ukraina ia shpërndaui të gjithë botës këtë informacion. Ukraina e fitoi luftën e informacionit, për të njëjtën arsye që Rusia e humbi atë. Ngeci e gjithë makineria ekonomike e Rusesë, e cila, me vetëm 0,73% të pasurive të botës që zotëron, guxoi të invadojë jo thjeshtë Ukrainën demokratike, por të kërcënojë tërë botën demokratike, e cila zotëron mbi 50% të pasurive të botës.

Rusia dështoi për shkak të llogarive të gabuara se fundi i botës përcaktohet vetëm nga eksporti i gazit dhe naftës ruse, duke megjulluar bumerangun që prodhon ky eksport për vetë Rusinë. Vërtet që nafta dhe gazi rus përbëjnë 14% të furnizimit botëror, por nga ana



Pse u tkurr makineria ruse e luftës



tjetër, nga shitja e gazit dhe e naftës Rusia mbulon 45% të buxhetit federal rus. Rusia u tkurr, sepse u udhëhoq nga planifikimi ushtarak, duke mos besuar dhe, madje, duke shpërfillur planifikimin dhe dialogun diplomatik. Harroi se bota e shekullit të 20-të u përshtjellua në dy luftëra botërore, pikërisht sepse u udhëhoq nga planifikimi ushtarak, jo nga diplomacia. Ndërkohë, harroi se bota e Luftës së Ftohtë shpëtoi nga një luftë e nxehtë, pikërisht sepse planifikimin ushtarak e udhëhoqi diplomacia, ajo amerikane dhe sovjetike së bashku.

Rusia dështoi, sepse nuk bëri dhe

as nuk mund të bënte për vete ushtarin rekrut rus, të cilit iu kërkua, ditën e fundit, të kalonte nga stërvitja, në luftë dhe, për më tepër, kundër një populli të të njëjtit grup sllav. Rusia dështoi, sepse i përhap forcat e saj mësimëse prej 150 000 - 200 000 ushtarësh në një front prej mbi 5 000 km të kufirit tokësor e detar të Ukrainës, me mesatarisht 30-40 ushtarë për kilometër, çka parakupton një disfatë të planifikuar pa filluar invazionin. Një përhapje, që i krijoi mundësi ushtarisë ukrainase të zbatojë me sukses taktikat e manovrës me njësi e reparte relativisht të vogla,

duke evituar grackën e ndeshjes në front në drejtimet kryesore të mësymjes ruse. Ushtria ruse, nuk e arriti dot superioritetin në ajër dhe as në tokë, edhe pse zotëron 15 herë më shumë avionin dhe 4 herë më shumë tanke se Ukraina. Komanda ruse nuk përllogarit që teatri i luftimeve do të "mbillej" me mbi 20 000 raketa supi e dhjetëra dronë, të cilat, veçanërisht në qytete e qendra të banuara, janë absolutisht superiore ndaj avionit e tankeve.

Strategjia ushtarake ruse nuk përllogarit se lufta në qytet është ndër llojet më të vështira të luftës, e cila kërkon

të paktën pesë sulmues për çdo mbrojtës dhe ku çdo pallat, çdo ndërtesë, është një fortifikatë më vete, me befasi nga më të paparashikuarat. Nuk mori parasysh që vetëm Kievi ka një gjysmë milioni të tilla! Ndoshta nuk ia deshi puna të kujtojë se në vitin 1942, gjatë Betejës së Stalingradit, trupat ruse arritën ta mbajnë një kompleks apartamentesh, për 58 ditë pa ndërprerje, duke zhvlerësuar sulmet e panumërta të këmbësorisë dhe mjeteve të blinduara gjermane. Një popull që fiton një luftë, forcon më shumë identitetin e vet. Madje, rruga për t'u bërë komb, fillon nga vuajtjet e përbashkëta. Dhe vuajtja më e madhe është lufta. Duke derdhur gjithnjë e më shumë gjak, ukrainasi bëhet më shumë ukrainas. Nëse ukrainasit nuk e kanë urreyer Rusinë më parë, tani vetë Rusia iu dha arsye ta urrejnë, me barbarizmin ndaj jetës dhe pasurive kombëtare të ukrainasve. Me invazionin në Ukrainë, lidhshipi dhe gjeopolitistët rusë përllogaritën përçarjen ndoshta të pariparueshme të NATO-s, përmes devizës se "Euro-Azia nuk duhet të kontrollohet nga dikush tjetër, përveçse nga Rusia, në aleancë me bllokun tradicional antiatlantist gjermano-francez". Kësisoj, Rusia i bëri llogaritë gjeopolitike mbi bazën e përqasjes së interesave të përkohshme tregtare dhe jo të vlerave të përhershme demokratike. Të përkundur me këtë klishe, oligarkët rusë e kanë të pamundur të konceptojnë se vërtetë Gjermania është 65% e varur nga gazi rus, por ajo nuk mund të sakrifikojë vlerat e veta demokratike për të hyrë në aleancë me autokracinë ruse.

USHTARAKËT HOLANDEZË NË SHQIPËRI...

Misioni i parë paqeruajtës ushtarak në Europë



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

Qeveria e Holandës informon përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha se Koloneli De Veer dhe Majori Tomson janë udhëzuar të nisen për në Shqipëri dhe të përgatisin një plan për krijimin e një xhandarmërie. Gazeta zyrtare e Qeverisë së Vlorës “Përlindja e Shqipërisë” lajmëron për të dy oficerët e lartë, që do të vinin në Shqipëri duke iu dhënë një gradë më e lartë nga Mbretëresha e Holandës. Pas bisedimeve me Qeverinë e Ismail Qemalit, Koloneli Tomson u mor me përgatitjen e dokumenteve për organizimin e Xhandarmërisë Shqiptare dhe me trajnimin ushtarak intensiv të nënrepartëve të sapokrijuara. Në fillim do të përgatiteshin një mijë vetë, ndërsa në tërësinë e saj. Xhandarmëria Shqiptare ishte parashikuar me pesë mijë vetë. Ndërsa Gjenerali De Veer bashkëpunoi më shumë me Komisionin Ndërkombëtar, si dhe drejtonte operacionet ushtarake në terren.

Xhandarmëria e krijuar dhe e komanduar nga oficerët holandezë, shfrytëzoi bazat e krijuara prej tij, I. Qemalit. Ajo i shërbente, në radhë të parë, qëllimit të caktuar, paqësimit të Jugut. Oficerët holandezë mbështeteshin më tepër te Komisioni i Kontrollit. Gjenerali De Veer dhe Koloneli Tomson, dhanë një shembull të admirueshëm vendosmërie dhe energjie dhe pavarësisht mungesës pothuajse totale të ndihmës, si dhe materialit tejet defektoz që kanë në përdorim, bënë një fillim shumë të mirë. Oficerët holandezë që u emëruan në shërbim të Xhandarmërisë shqiptare ishin pesëmbëdhjetë dhe përbënin Misionin Ushtarak në Shqipëri. Ky ishte një Mision Ushtarak Paqeruajtës dhe Organizator Ushtarak për shtetin e ri shqiptar, që mund të vlerësohet si misioni i parë paqeruajtës ushtarak në Europë. Grupi i oficerëve holandezë që erdhi në Vlorë u prit nga togeri Gerard Mallinckrodt, i cili ishte ndihmës i Kolonelit Tomson, si dhe togeri Meleq Frashëri, si përfaqësues nga Komanda e Xhandarmërisë Shqiptare, kapiten Tole Arapi dhe Mihal Grameno.

Përgatitja e detashmenteve të Xhandarmërisë shqiptare

Koloneli Tomson e kishte ndarë vendin në pesë zona, të cilat ishin Korça, Gjirokastra dhe Jugu i Shqipërisë, Elbasani, Durrësi dhe Shkodra e Veriu i Shqipërisë. Ndaj dhe oficerët holandezë udhëtuan me shpejtësi në drejtim të zonave, ku ishin caktuar, bashkë me trupat e sapokrijuara të nënrepartëve të Xhandarmërisë shqiptare.

Marrja e detyrës ushtarake ishte tepër e rëndësishme për ta, si oficerë të karrierës ushtarake. Në shtypin e kohës, si në Vlorë, në Shkodër e Korçë përshkruhen veprimet dhe qëndrimet e tyre, sidomos për rastet kur janë përfshirë në luftime dhe beteja, si në Korçë dhe në



zonën Tepelenë-Gjirokastrë. Nën drejtimin e oficerëve holandezë në Vlorë dhe në Durrës u përgatitën disa detashmente të Xhandarmërisë shqiptare. Gjenerali De Veer dhe Koloneli Tomson i kishin krijuar, por edhe i kishin trajnuar këto reparte. Ata kishin hartuar edhe planin operacional për lëvizjen e tyre për marrjen në dorëzim të territoreve, që duhej të lironin trupat ushtarake greke, si dhe bandat e krijuara dhe të furnizuara prej tyre. Ishte planifikuar që tetë kolona ushtarake të niseshin në fillimin e marsit 1914 në rrugëkalimet drejt Himarës, Tepelenës, Frashërit dhe Voskopojës.

Njëra kolonë pasi kaloi grykën e Vjosës në drejtim të Tepelenës u bombardua nga ushtria greke afër Sinanajt, në lartësinë e Gribës. Forcat u kompaktësuar dhe marshuan drejt Gjirokastrës. Në këtë kolonë kishte 400 xhandarë dhe rreth 1.200 luftëtarë popullorë vullnetarë, bashkë me çetën e Çerçiz Topullit. Edhe kolona me detashmentin tjetër në drejtimin e Këlcyres dhe Përmetit

u pengua nga trupat ushtarake greke. Situata në drejtimin e Himarës, ku po lëviznin rreth 100 xhandarë, u prit me armë nga pasuesit e ushtarëve grekë në hyrje të Vranishtit. Oficerët shqiptarë e rivendosën situatën dhe ngritën flamurin kuq e zi. Kolona e nisur për në Jug-Lindje, pati më shumë sukses, ajo kaloi Voskopojën dhe mori në dorëzim Korçën. Kolona mbajti rregull në qytet dhe shkatërroi edhe komplotin e organizuar në fillim të prillit nga ushtarët grekë. Luftimet vazhdonin rreth Gjirokastrës, si dhe në drejtimin Këlcyre-Përmet.

Situata e rëndë ushtarake dhe oficerët holandezë

Oficerët e parë holandezë u ndodhën në situata të rënda ushtarake, por trupat shqiptare siguruan rrethet jugore të Gjirokastrës dhe Korçës. Në vend të rindërtimit, iu desh të hynin në luftë me grekët pothuajse menjëherë. Kjo situatë do të zgjaste deri në fund të misionit. Ndërsa në librin “Shqipëria, e shkuara

dhe e tashmja” të Kostë Çekrezit, shkruhet se shqiptarët e ngushtuan darën rreth Gjirokastrës... Ata pothuaj po e shtinin në dorë qytetin, kur, në çastin vendimtar, Gjenerali Papulias, i Ushtrisë Mbretërore Greke, hodhi këmbësorinë dhe artilerinë kundër shqiptarëve, që po avanconin, duke i detyruar këta të ndalojnë. Ndërsa në zonën tjetër, të Korçës, kolona arriti të mposhtë edhe një komplot të armatosur, si dhe morën në dorëzim Bilishtin, Ersekën dhe Leskovikun. Princ Vidi, në kujtimet e tij shkruan se: “...greqët kishin organizuar edhe në Durrës, nën drejtimin e peshkopit grek, një sistem të plotë dhe tejet efektiv spiunazhi... dhe dërguan një farë Dr. Voila, i cili krijoi lidhje të afërta edhe me Esatin dhe, siç mësova më vonë, i kishte sjellë atij shpesh herë të holla”. Marrëveshja e grekëve me Esatin kishte filluar që atëherë kur pashai luftonte kundër Qeverisë së Ismail Qemalit. Atëherë i ishin bërë dhe pagesat e para Esatit

prej emisarëve grekë. Princ Vidi nuk e vlerësoi situatën. Ai u mbyll në Pallatin Mbretëror, duke shpresuar se do ta ndihmonin Fuqitë e Mëdha, që kishin anijet luftarake në Gjirin e Durrësit. Por e vërteta ishte krejt ndryshe. Kur qyteti u sulmua, komandantët e tyre u thirrën për të shtënë ca topa sa për të trembur kryengritësit, por ata kundërshtuan, duke thënë se kanë urdhra të rrepta për të vepruar vetëm për mbrojtjen e personit të Princit e të familjes së tij. Kjo tregoi qartazi se Fuqitë e Mëdha kishin vendosur për të mos qëlluar me asnjë top për mbrojtjen e qeverisë që kishin marrë përsipër për të themeluar.

Në këtë situatë politike dhe ushtarake, kur përzihej rebelimi fetar në Shqipërinë e Mesme me luftimet në Shqipërinë e Jugut, oficerët holandezë bënë të pamundurën për të shmanhur shkatërrimin shtetëror. Trupat e xhandarmërisë së re shqiptare, të komanduara nga oficerët holandezë e vlerësuan si përparësi të madhe situatën në Jug. Problem i madh po bëhej rebelimi fetar dhe rrethimi i Durrësit. Princ Vidi kreu një inspektim të të gjitha forcave ushtarake, në mbrojtje të Durrësit, ku shoqërohej nga Koloneli Tomson, i cili ishte caktuar Drejtor i Forcave të Armatosura, si dhe Komandanti Legjendar Isa Bolelini. Përveç vullnetarëve, qyteti mbrohej nga 100 malësorë të armatosur, të cilët me të marrë kumtin e kryengritjes, shpejtuan t’i vinë në ndihmë Princit të tyre. Për mbrojtjen e Pallatit Mbretëror, kishin zbarkuar marinarët italianë dhe austriakë. Në Durrës numri i përgjithshëm i shqiptarëve të armatosur kapte rreth 300 vetë, prej të cilëve 200 ishin xhandarë.

Nderimi për komandantin holandez Tomson

Në këtë kohë oficerët holandezë ishin të vetmit mbrojtës të Durrësit duke komanduar malësorët shqiptarë, gjuhën e të cilëve as që e kuptonin. Komandanti holandez Tomson me shokë, përpiquej jashtëzakonisht për t’i organizuar malësorët. Ata ia dolën mbanë dhe i nisën deri te Ura e Dajlanit. Tomsoni, i hipur mbi kalë, shkoi përpara deri tek vija e parë, por u qëllua në kraharor dhe ra në tokë. Historia e Tomsonit është botuar tek ne. Busti i tij është vendosur në krye të Rugës “Tomson” në Durrës, si dhe u shpall “Qytetar Nderi” i qytetit në vitin 2000. Emrin e Tomsonit e mban Akademia Ushtarake e Nënoficerëve në Tiranë.

Me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, Koloneli Tomson është dekoruar në vitin 2003, nga Presidenti i Shqipërisë, me Urdhrin e “Shqiponjës të Artë”. Ushtaraku Fluturak Gërmenji ka botuar librin “Misionit Holandez” në Shqipëri.

Forcat Speciale dhe ato Komando mirëpritën vizitorë të veçantë sot në Zall-Herr



Gjimnazistët e “Qemal Stafës” kaluan një ditë interesante mes trupave, armatimeve dhe pajisjeve të dy prej strukturave më elitare të Forcave tona të Armatosura.

